

G

K

P

H

G

T

N

G

O

H

P







The National Gallery Oral History Project /
Galeria Kombëtare Projekti i Historisë Gojore

Lead Researcher / Udhëheqëse e Hulumtimit
Erëmirë Krasniqi

Publisher / Botues
National Gallery of Kosovo / Galeria Kombëtare e Kosovës
Oral History Initiative / Iniciativa për Histori Gojore

Transcription / Transkriptimi
Donjetë Berisha

Translation / Përkthimi
Aurela Kadriu
Dafina Tahiri

Albanian Proofreading / Lektorimi në Gjuhën Shqipe
Aurela Kadriu
Erëmirë Krasniqi

English Proofreading / Lektorimi në Gjuhën Angleze
Rachel Pafe
Chester Eng
Erëmirë Krasniqi

Book Cover / Kopertina e Librit
Blerim Luzha
Design / Dezen Il 30 x 90cm
Mixed media / Teknikë e Kombinuar, 1973

Design / Dizajni
Nita Salihu Hoxha

© 2018
National Gallery of Kosovo / Galeria Kombëtare e Kosovës
Oral History Initiative / Iniciativa për Histori Gojore

National Gallery of Kosovo / Galeria Kombëtare e Kosovës
Agim Ramadani 60, 10000 Prishtinë, Kosovë / galeriakombetare.com

Oral History Initiative / Iniciativa për Histori Gojore
Rruga UÇK B2/13, 10000 Prishtinë, Kosovë / oralhistorykosovo.org

This research—based publication is supported by the Ministry of Culture, Youth
and Sports / Ky publikim i bazuar në hulumtim është mbështetur nga Ministria
e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve



National Gallery of Kosovo staff / Stafi i Galerisë Kombëtare të Kosovës:
Arta Agani, Director / Drejtoreshë; Zeni Ballazhi, Curator / Kurator;
Mexhide Maxhuni, Finance officer / Zyrtare për financa; Lirije Buliqi, Senior
administrative officer / Zyrtare e lartë administrative; Naim Spahiu, Exhibition
Coordinator / Koordinator për ekspozita; Engjëll Berisha, Coordinator for
international projects and PR / Koordinator për projekte ndërkombëtare
dhe MP; Enver Bylykbashi, Professional photographer / Fotograf profesional;
Skender Xhukolli, Exhibition technician / Teknik për ekspozita; Rrahman
Bislimi, Exhibition technician and Building manager / Teknik për ekspozita dhe
Mirëmbajtës i objektit; Xhevat Rrahimi, Exhibition hall attendant / Kujdestar i
sallës ekspozuese; Valdet Syla dhe Mentor Abdullahu, Security / Roje.

G

K

P

H

G

T

N

G

O

H

P

The National Gallery Oral History Project

Galeria Kombëtare

Projekti i Historisë Gojore

Contents

10	Introduction by Erëmirë Krasniqi
	Interview with
15	Agim Rudi
83	Alije Vokshi
99	Blerim Luzha
131	Shyqri Nimani
191	Tomislav Trifić
223	Xhevdet Xhafa

Përmbajtja

11	Hyrje nga Erëmirë Krasniqi
	Intervistë me
15	Agim Rudi
83	Alije Vokshi
99	Blerim Luzha
131	Shyqri Nimani
191	Tomislav Trifić
223	Xhevdet Xhafa

Introduction by Erëmirë Krasniqi

This series of interviews documents the lives of artists and art professionals who worked in Kosovo and were part of the art scene in the 1970s, and steadily gained recognition in the Yugoslav art space over two decades. The political context that gave rise to the visual arts came to represent Kosovo's golden age in Yugoslavia. This period of great prosperity seemed to be at the core of institutional memory, including that of cultural institutions. It is no wonder that the Gallery of Arts in Pristina, today the National Gallery of Kosovo, was established in 1979, becoming the first arts institution to define how works of art would be displayed and communicated to the public.

The interviews were conducted as part of the research connected to the National Gallery of Kosovo's collection. The collection provides a unique opportunity to trace different genealogies of modernist formations rooted in the Yugoslav ethos, and as such it underscores the copresence of multiple temporalities within the narrative of modernist art in Kosovo. Little is known about the collection because not much knowledge has been produced thus far. Therefore, to understand the collection and to know how to read the works of art within it, an oral history project provided a way to delve into the context that gave rise to the collection.

Whilst this series of interviews tries to discuss each artists' working practice, it is important that they are first-person narratives, rooting the speakers in the society that formed them rather than isolating them within the art world. Their life narratives are rich with references embedded in a world that is no longer visible. The aim of these interviews is to enable Kosovo artists and art professionals to create records of their experiences in their own words to complement, enlarge and sometimes challenge accounts by other commentators.

The oral history video-recordings provide valuable first-hand testimonies of events of the past. The views and opinions expressed in oral history interviews are those of the interviewees, who describe events from their own perspectives. The interviews are historical documents and their language, tone and content reflect attitudes of times past in dialogue with the interviewee's current worldviews.

What we present in this book are transcripts of the video-recordings. The division in parts encountered in the transcripts corresponds to the divisions of video-interviews. The transcripts as such take note of other ways of knowing and imparting knowledge, therefore it transcribes emotional responses and body language, while footnotes are added to facilitate comprehension of cultural specificities. This is visible, particularly in the case of English interview translations. The transcript follows speech patterns, which sometimes renders the transcript unreadable.

The works of art framing each interview are part of the National Gallery of Kosovo's art collection. They might not always represent artists' most iconic works of art, but, nonetheless, they offer invaluable insight into the larger historical dynamics and artistic developments of the time.

The National Gallery Oral History Project was initiated in late 2016 by Oral History Initiative in collaboration with the National Gallery of Kosovo. The video-interviews will be published on the Oral History Initiative online archive and the National Gallery of Kosovo website.

Lastly, we would like to thank the artists and art professionals who sat with us and shared their life stories, and for their kind permission to publish the interviews.

Hyrje nga Erëmirë Krasniqi

Kjo seri e intervistave dokumenton jetërat e artistëve dhe profesionistëve të artit të cilët kanë punuar në Kosovë dhe kanë qenë pjesë e skenës së artit që nga vitet 1970, dhe të cilët përgjatë dy dekadave kanë fituar njohje në hapësirën artistike jugosllave. Konteksti politik që i dha formë artit pamor u bë përfaqësues i epokës së artë të Kosovës në Jugosllavi. Kjo periudhë e prosperitetit ishte në thelb të secilës kujtesë institucionale, duke përfshirë edhe institucionet kulturore. Nuk është çudi që Galeria e Arteve në Prishtinë, e cila sot njihet si Galeria Kombëtare e Kosovës, u themelua në vitin 1979, duke u bërë institucioni i parë i artit që definonte se si punët artistike do të ekspozoheshin dhe do t'i komunikoheshin publikut.

Intervistat janë realizuar si pjesë e hulumtimit që lidhet me koleksionin e Galerisë Kombëtare të Kosovës. Koleksioni ofron një mundësi të veçantë për të gjurmuar gjenealogjitë e ndryshme të formacioneve moderniste të rrënjësura në karakterin jugosllav, dhe si i tillë nënvizon praninë e kohësisë së shumëfishtë përbrenda narrativës së artit modernist në Kosovë. Shumë pak dihet për koleksionin, sepse deri tani nuk është prodhuar shumë dije mbi të. Prandaj, për të kuptuar koleksionin dhe për të ditur si të i analizosh punët e artit që janë pjesë e tij, projekti i historisë gojore ka ofruar një mënyrë për t'u futur në kontekstin që i dha formë koleksionit.

Ndërkohë që kjo seri e intervistave provon të flasë për praktikën e punës së artistëve, është e rëndësishme se këto janë narrativa në vetën e parë, duke i rrënjësuar të intervistuarit në shoqërinë që i ka formësuar e jo duke i izoluar ata përbrenda botës së artit. Narrativat e tyre jetësore janë të pasura me referenca të mishëruara në një botë e cila nuk është më e dukshme. Qëllimi i këtyre intervistave është që t'ua mundësojmë artistëve dhe profesionistëve të artit në Kosovë të krijojnë një dokumentim të përvojave të tyre sipas fjalëve të tyre, për të plotësuar, zhvilluar dhe nganjëherë edhe sfiduar tregimet nga komentuesit e tjerë.

Video—inçizimet e historisë gojore ofrojnë prova të vlefshme të dorës së parë nga ngjarjet e së shkuarës. Pikëpaamjet dhe qëndrimet e shprehura në intervistat e historisë gojore janë të intervistuesve, të cilët përshkruajnë ngjarjet nga perspektiva e tyre. Intervistat janë dokumente historike dhe gjuha, toni e përmbajtja e tyre reflektojnë qëndrime të kohës së kaluar në dialog me qëndrimet e tanishme të të intervistuarit.

Ajo që prezantojmë në këtë libër janë transkriptet e video—intervistave. Ndarja në pjesë e transkripteve korrespondon me ndarjen e video—intervistave. Transkripti si i tillë merr shënime të mënyrave të tjera të dijes dhe kumtimit të saj, prandaj transkriptohen reagimet emocionale dhe gjuha trupore, ndërkohë që fusnotat shtohen për të ofruar kuptueshmëri të specifikave kulturore. Kjo është e dukshme, posaçërisht në përkthimin e intervistave në gjuhën angleze. Transkripti përcjell paterna të gjuhës së folur, gjë e cila nganjëherë e bën transkriptin të palexueshëm.

Punët artistike që kornizojnë secilën intervistë i takojnë koleksionit të artit të Galerisë Kombëtare të Kosovës. Ato jo medomos përfaqësojnë punët artistike më ikonike të artistëve, por, megjithatë, ofrojnë një pasqyrë të çmueshme mbi dinamikat më të mëdha historike dhe zhvillimet artistike të kohës.

Galeria Kombëtare Projekti i Historisë Gojore është nisur në fund të vitit 2016 nga Iniciativa për Histori Gojore në bashkëpunim me Galerinë Kombëtare të Kosovës. Video—intervistat do të publikohen në arkivin online të Iniciativës për Histori Gojore dhe në web-faqen e Galerisë Kombëtare të Kosovës.

Në fund, do të donim t'i falenderojmë artistët dhe profesionistët e artit të cilët u ulën me ne dhe ndanë tregimet e tyre jetësore, dhe për lejen e publikimit të intervistave.

Interviews

Intervistat

Agim Rudi

Agim Rudi was born in 1947 in Gjakova, Kosovo. In 1977, Rudi graduated from the Department of Sculpture, Faculty of Figurative Arts at the University of Ljubljana in Slovenia, under the mentorship of Zdenko Kalin. Upon graduation, he worked as a scenographer for Radio Television of Pristina, and later taught sculpture at the Faculty of Figurative Arts at the University of Pristina. Recently, Rudi has retired. He lives in Pristina with his family.

Agim Rudi u lind më 1947 në Gjakovë, Kosovë. Në vitin 1977, Rudi diplomoi nga departamenti i skulpturës, Fakulteti i Arteve Figurative, Universiteti i Lublanës, Slloveni, në klasën e Zdenko Kalin. Pas diplomimit ka punuar në Radio Televizionin e Prishtinës si skenograf, dhe më vonë ligjeroi lëndën e skulpturës në Fakultetin e Arteve Figurative në Universitetin e Prishtinës. Së voni, Rudi është pensionuar. Ai jeton në Prishtinë me familje.

Interview

Interview with Agim Rudi
Pristina | Date: August 25, 2017
Duration: 156 minutes

Present:

Agim Rudi (Speaker)
Erëmirë Krasniqi (Interviewer)
Donjetë Berisha (Camera)
Nevryze Rudi (Agim Rudi's spouse)

Transcription notation symbols of non—verbal communication:

- ◊ Emotional communication
- ✎ The speaker explains something using gestures.

Other transcription conventions:

- [] Addition to the text to facilitate comprehension
Footnotes are editorial additions to provide information on localities, names or expressions.

Intervistë

Intervistë me Agim Rudin
Prishtinë | Data: 25 gusht, 2017
Kohëzgjatja: 156 minuta

Të pranishëm:

Agim Rudi (I intervistuari)

Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)

Donjetë Berisha (Kamera)

Nevryze Rudi (Bashkëshortja e Agimit)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo—verbal:

⓪

Komunikim emocional

⌋

I intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[]

Shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime,
emra apo shprehje.

Part One

[The interviewer asks the speaker to introduce himself in front of the camera. The question was cut from the video—interview.]

AR I was born on June 10, 1947. I was born in Gjakova. Even though my family was from Gjakova, they lived in Mitrovica, my father had a store. Earlier in Mitrovica there weren't two stores that sold nails, dye, henna, and fabrics. There was one store, and it was my father's store. And... in '44, it was very problematic in Mitrovica, a very problematic time, chetniks¹ settled near Mitrovica, very near. They always lived in one part of Mitrovica, they were a lot, a few were in Mitrovica and a few were a bit further away from Mitrovica, they were always near Mitrovica, the chetniks.

In '44, my father and his whole family fled to Gjakova, there were two of them, there was one brother, two brothers, actually one was born then, there was one brother. There were one brother and two sisters, we fled to Gjakova, my house was in Gjakova because Gjakova people go to work somewhere, either in Ferizaj or in Gjilan, or somewhere, they leave their family in Gjakova but this is how they lived, this is how they lived in Gjakova... people of Gjakova in Mitrovica...

EK When did you return to Mitrovica?

AR We returned slowly, slowly... I'll tell you how. My father was afraid that the communists would declare him a *ratni bogataš*² because when you had a store at that time you were observed closely by communists. He was not very fond of communists but apparently he did not tell anyone, I suppose, and it was, it was a hard time in Gjakova. People did not have bread to eat, in Gjakova where the good... they lived well in Gjakova, the people mainly lived well, mainly (coughs).

And... but we were good, our family was well, we had food

on the table and then sometime in '49, '48 or '49, I don't know exactly but sometime around then we came back. He somehow found a job because it was very hard for him to find one, to get a state job. It was a really big problem for Albanians, it was considered quite a failure to work for the government.

EK Can you explain?

AR [The documentary] shows how Albanians work, they do not work for the state, they run private businesses because they never trusted the state and they were never close with the state, that was absurd, absurd. They're all under Macedonia, under the same flag, they work under the same constitution... This seem to characterize them, you know. And he had the whole store to himself, he knew how to run it, he knew how to manage it, my father.

My mother had a problem, she often told me, very often. In the evening after all the chores, having four children means there are a lot of clothes to be washed, there were no washing machines back then and to be clean and stuff... In the evening when they went to sleep it was big responsibility to count the money. That was my mother's biggest problem, apparently, I don't know how much money there was, there wasn't much. But it was a problem for my mother, she counted it in the evening {explains with his hands} the green ones [bills], the red ones, all that was there. It was one of the biggest problems for my mother (laughs). And, good, this story is over, and my father continued alone, he was employed by the state, at the Granap Enterprise, in Serbian it is Granap, the whole world worked at Granap at the time.

EK What sort of company was this?

AR I do not know, they sold flour and he was *hesapçi*,³ he knew how to write, he knew how to write in Arabic, Serbian Cyrillic. I saw his writing, I did not understand Arabic but he wrote everything in Cyrillic. At the time, knowing how to write

1
Četniks, Chetniks; Qetniks; Çetnikët—Serbian movement born in the beginning of the Second World War, under the leadership of Draža Mihailović. Its name derives from četa, anti—Ottoman guerrilla bands. This movement adopted a Greater Serbia program and was for a limited period an anti—occupation guerrilla force, but mostly engaged in collaboration with Nazi Germany, its major goal remaining the unification of all Serbs. It was responsible for a strategy of terror against non—Serbs during the Second World War and was banned after 1945. Mihailović was captured, tried and executed in 1946.

2
Serb.: *Ratni bogataš*, describes people who acquired wealth during the war.

3
Turkish: *Hesapçi*, the term refers to people who know accounting.

Pjesa e Parë

[Intervistuesja kërkon nga folësi të flet rreth kujtimeve të hershme të fëmijërisë. Pyetja është prerë nga video—intervista.]

AR Unë jam lindë me 10 qershor, 1947. Jam lindë në Gjakovë. Familja ime edhe që ka qenë gjakovare, ata kanë jetu në Mitrovicë, babai im ka pasë dyqanin. Përpara në Mitrovicë s'kanë qenë dy dyqane, që ka shitë gozhda edhe ngjyrë, konë, basëm. Ka qenë një dyqan, ate e ka pasë baba jem. Edhe... '44, në Mitrovicë ka qenë shumë problematike, natyrë shumë problematike, çetnikët kanë ekzistuar po ngat Mitrovicës shumë afër. Ata gjithë kanë jetu në një pjesë në Mitrovicë, shumë kanë qenë, pak në Mitrovicë edhe pak jonë ikë ma larg Mitrovicës. Gjithnjë kanë qenë afër Mitrovicës, çetnikët.

Në '44—tën, baba im ikë me krejt familjen në Gjakovë, kanë qenë dy, kanë qenë një vëlla, dy vëllazën, vërtetë njeni lindë mandej një vëlla ka qenë. Një vëlla ka qenë edhe dy motra, ikim në Gjakovë. Në Gjakovë ka qenë shpia jem, se ata gjakovarët shkojnë me punu dika ja në Ferizaj ja në Gjilan ja në andej, familjen e kanë lonë në Gjakovë po këtu qashtu kanë jetu, kështu kanë jetu në Gjakovë... Gjakovarët në Mitrovicë...

EK Kur u kthyet prapë në Mitrovicë?

AR Mandej jena kthy ngadalë—ngadalë... që veç t'ju tregoj qysh. Baba jem është frigu që po e shpallin ratni bogataş¹ se me pasë dyqan në atë kohë të kanë ndjekë këta komunistat. Ky s'i ka dashtë shumë komunistat por si duket s'i ka kallxu kërkujt, këta po supozoj edhe ka qenë, ka qenë kohë e vështirë në Gjakovë. Njerëzit nuk kanë pasë me hongër bukë, në Gjakovë ku e mira... kanë jetu mirë në Gjakovë, populli ka jetu mirë kryesisht, kryesisht (kollitet).

Edhe... po ne kena qenë mirë, familja jonë ka qenë mirë ka pasë çka me hongër edhe

mandej dikur në '49, '48 a '49 saktë s'e di, por qaty dika jena kthy. Ky e ka gjetë dyqysh një punë se për te ka qenë kijamet me gjetë, me hi në punë të shtetit. Shqiptarët kanë qenë problem shumë i madh, dëshitim shumë i madh me hi në punë të shtetit.

EK
AR

A mundesh me spjegju?
[Dokumentari] Po tregon këta shiptarët punojnë, nuk punojnë në të shtetit, punojnë privat se kurrë s'i kanë besu shtetit edhe kurrë s'kanë qenë të afërt me shtetin ajo ka qenë absurd i madh, absurd. Krejt në një Maqedoni jonë, nën një flamur, një kushtetutë punojnë... kjo duket karakteristike e madhe, a din? Edhe ky e ka pasë gjithë dyqanin, gjithë ka ditë me udhëheqë, ka ditë me menaxhu dyqanin baba.

Nana jem, ajo e ka pasë një problem më ka tregu shpesh, shumë problem. Në mbramje mas krejt punëve, katër fëmijë me i pasë duhet me la shumë tesha, maqina s'ka pasë atëhere edhe për me qenë e pastër e sende... E në mramje kur jonë ra me flejt ka qenë obligim shumë i madh me ngjehë pare. Ai ka qenë problemi ma i madh i nanës tem, si duket, nuk e di sa kanë qenë ato pare, s'kanë qenë kushedi çka, por për nanën time kanë qenë problem. I ka ngjehë mbramje për mbramje {shpjegon me duar}, të gjelbërta, të kuqe, çka kanë qenë. Kanë qenë një prej problemeve ma të mëdhaja të nanës tem (qeshë). Edhe, mirë kryhet ajo storie edhe vjen baba vazhdon vetëm është i punësum në shtet në sipërmarrjen "Granap" serbisht është "Granap", të gjithë krejt bota kanë punu në "Granap" në atë kohë.

EK
AR

Çfarë kompanie ka qenë kjo?
S'e di, miell ka shitë e ky ka qenë hesapçi, ka ditë me shkru, ka ditë me shkru arabisht, çirilicë serbisht. Ja kom pa shkrimet e tij s'kom kuptu arabisht, por çirilicë ka shkrujtë krejt. Në atë kohë me ditë me shkrujtë në '47 ka qenë privilegj i madh, baba jem prandaj u punësu aty.

1
Serbisht: Ratni bogataş, përfitues në kohëra të luftës.

in '47 was a huge privilege, that's why my father was employed there.

EK How did he know, did he get an education or what kind of education existed at that time?

AR He did go, he did go... in Gjakova he attended that school, just do not ask me which education. I do not know exactly, it was an education where they were taught to write. The small Madrasas,⁴ mejtep⁵ were those high schools, I do not know how to call them. That is a story on its own you know, I'm not going to go there. But that was the beginning of... when he died, his last words to my mother, he died early, I was six years old when he died, my brother was four years old, he did not know, he was playing, stopping him from playing was a problem. So when he died his amanet⁶ to my mother was that, "All the gold, everything has to go towards... just finish school, finish school because only school brings out the good," he said to my mother. Then my mother brought up five children on her own, she was very young, it was hard.

I know this as well, that at that time you couldn't study without a scholarship, if you did not have a scholarship. And they could not get a scholarship because you could not get a scholarship if you had land, we had shares, the brothers had shares of land, they had land and stores and everything. She [my mother] sold everything, she signed with the municipality, someone bought the land, someone bought the store, someone this and that. And then you could get it, my mother was obsessed, "We have to sell everything, sell everything. You should study, without a scholarship you cannot study." And we all studied.

I definitely know now how the story goes. For example it happened to me, I went... there was a movie, Era dhe Lisi⁷ and we went to ask for permission, when he [a man there] said, "Who are you?" "I work for television." "What's your name?" "Agim Rudi." "This was your father's store." Imag-

ine what value that moment had... I would say to myself, "Oh God... God!" Maybe this is not relevant. But I just want to show how the desire for education, how it started, it started through my father and was passed down to my mother and then to all three of us, the sons, two sons, actually the three sons and two sisters, we were all educated, we were the family in which everybody was in school.

At that time it was very... today you cannot understand what I am saying, you will understand, and you believe me and everything, it was... to go to school, to have everybody go to school [was difficult]. Then do you know what sort of issues my sisters had, my sister, to get married, my sister with mathematics, with a mathematics degree, who graduated in Belgrade in '53—'54. At that time, who should she marry, who? She could not marry a cobbler and so on. Hard, she hardly got married. These were some very obvious problems you know, strange things. And then slowly I finished primary school, I had problems at home since primary school.

My brother played the violin, I did not play the violin or any instrument, every time guests came they made Rafet play the violin {explains with his hands}. Rafet does not like talking about this, does not like it at all. I envied him, because I could not [play]. We read a lot for the sake of our brothers and sisters, we read a lot, I read more as a 15—16—17 year old than when I became a professor. No, no then I read a lot because my brother, my sisters were students in Belgrade, they read... this was very, very important, I had to read. I was registered at the local library, the library was very big in Mitrovica, Trepça improved the whole economic situation, we had a different life in Mitrovica, which was not the case in Gjakova, or Ferizaj, or anywhere else.

EK Can you tell us about Mitrovica and your primary educa-

4 Muslim religious school, the only school where teaching could be conducted in Albanian until 1945.

5 Mejtep, Maktab (Arabic transliterations include mak-teb, mekteb, mektep, meqteb, ma-qtab), also called a Kuttab or school, is an elementary schools. Though it was primarily used for teaching children how to read, write, grammar and Islamic studies such as Qira'at (Quranic recitation), other practical and theoretical subjects were also often taught.

6 Amanet literally means the last will, but in the Albanian oral tradition it has a sacred value.

7 Era dhe Lisi is a Kosovo Albanian movie directed by Besim Sahatçiu and produced by Kosovafilms in 1979.

EK Qysh ka ditë ai, a ka viju ndonjë edukim, a çfarë edukimi ka ekzistuar në atë kohë?

AR Ka shku, ka shku... në Gjakovë ka shku në atë edukimin, veç mos më pyt në cilin edukim. Nuk e di saktë, ka qenë edukim ku kanë mësu me shkru. Medresetë e vogla, medresetë ato shkollat e mesme mejtepet e kanë pasë emrin, por nuk po e di si me i qujtë. Ajo është storie në veti a din, hiç mos të dal anej. Po aty janë edhe fillet e asaj që... kur ka vdekë i ka lonë amanet nanës time, ka vdekë herët, unë i kom pasë gjashtë vjet kur ka vdekë, ai vëllau im i ka pasë katër vjet hiç sé din, ai lujke, ish problemi qysh me ndalë mos me lujtë. Edhe kur ka vdekë i ka lonë nanës time amanet, ka thonë, "Krejt çka ka dukat, a krejt, veç kqyrni shkollën, me i kry shkollat se vetëm ajo bjen të mirën", nanës time. Nana ime mandej i ka rritë pesë fëmijë, e re shumë a din, shumë vështirë ka qenë.

Edhe këto të dhëna i di, në atë kohë s'ke mujtë me studiu pa stipendion, pa pasë një stipendion. E këta s'kanë mujtë me marrë stipendion se s'ke mujtë me marrë stipendion nëse ke pasë tokë. Ne kemi pasë hise shumë, tokë, vëllaznit kanë pasë hise, kanë pasë tokë e dyqane e krejt. [Nana] Ka shku krejt i ka shitë, në komunë aty u nënshkru, dikush e ka ble tokën, dikush e ka ble dyqanin, dikush. Edhe mandej ke mujtë me marrë. E ka pasë fiksime nana, "Duhet me i shitë krejt, duhet çdo gjë. Duhet me studiu, pa stipendion nuk mundesh me studiu". Edhe kemi studiu.

Tash definitivisht e di qysh ka qenë historia. Mua më ka ndodhë, për shembull kom shku e kena pasë një film, "Era dhe Lisi" po shkojmë me lypë leje, kur ai ka thonë, "Kush jeni ju?" "Unë punoj në televizion", "Qysh e ki emrin?" "Agim Rudi." "Ky dyqan ka qenë i babës tonde". Merre me mend a din qysh çfarë vlere tash kishte thojsha, "Eh Zot..." Mirë, ndoshta s'ka edhe lidhje kjo. Po veç dëshirën për arsimim po du me tregu qysh ka, ka ardhë ajo nëpërmjet babës ka ardhë te nana edhe mandej na

të gjithë tre djemtë, dy djemtë, tre djemtë në të vërtetë dhe dy motrat, krejt kena qenë të arsimim, na jena kanë ajo familja që shkojnë krejt në shkollë.

Shumë në atë kohë ka qenë... sot ju nuk mundeni me kuptu çka jom t'u thonë, e kuptoni, e besoni e krejt, por është... ka qenë me shku në shkollë krejt njerëzit me shku në shkollë. Mandej motrat e mia, a din çfarë problemi kanë pasë motrat e mia m'u martu? Motra jeme me matematikë, me fakultet të matematikës në Beograd të kryem, '53—'54. Në atë kohë kend me marrë për burrë, kend? S'ka mujtë një këpucëtar a një kështu. Vështirë, mezi u martu. Këto kanë qenë probleme shumë evidente, a din gjana të çuditshme. Edhe mandej dalë—ngadalë u kry shkolla fillore, mu qysh në shkollë fillore unë kom pasë problem në shpi.

Vëllau im i ka mëshu violinës, unë s'kom ditë as violinës as kurçkafit me i mëshu, si janë ardhë mysafirët e kanë shti Rafetin me i mëshu violinës {spjegon me duar}. Rafeti s'ka qejf me kallxu hiç këta, hiç s'ka qejf. E mu shumë më ka ardhë inati, shumë se s'disha. Na kemi lexu shumë për hirë të këtyne vëllaznive e motrave, kemi lexu shumë, unë ma shumë kom lexu 15—16—17 vjeçar se sa tash kur jom bo profesor. Jo, jo atëhere kom lexu shumë se këta vëllau, motrat kanë qenë studenta në Beograd, kanë lexu... kjo shumë, shumë me rëndësi ka qenë, unë s'kom pasë qare pa lexu. Bile kom qenë i regjistruar në bibliotekë, në Mitrovicë ka qenë biblioteka shumë e madhe, krejt Trepça, gjendja ekonomike [e mirë] që në Mitrovicë me qenë një jetë tjetër, as në Gjakovë, as në Ferizaj as kërkun s'u bo qasi jete.

EK A mundeni me na tregu për Mitrovicën edhe për edukimin e juaj fillor, si ka qenë atëherë?

AR Ka qenë e mirë, por kjo pjesa në shpi që unë e kom përjetu ka qenë shumë e mirë. E këtë sé kanë pasë gjithë, unë kom lexu romane, kom lexu, 17 vjeçar romane, Tolstoyin e kom lexu. S'i kom kuptu krejt po i kom

AR tion, how was it then?
It was good but the part that I experienced at home was the best. And they did not always want me to read novels, I read, 17 years old, novels, I read Tolstoy. I did not fully understand them but I read all of them, I read all of Dostoyevsky. The Serbian language, Mitrovica should not know Serbian, I had Serbian neighbors, I had them like this {explains with his hands} today people are surprised you know... Then there was a lot of sports, we went to the pool when I was ten years old with my brother, people in Kosovo did not know what a pool was. Do you understand that Trepça brought all these schools, all these... libraries, I remember, that woman was called Sadie, I had to take books, because I could not be without books. You know when this book was being read, this book, they read a lot in my house. Oh... God, oh God, we were crazy, very ambitious. Then, because this really had an impact on being able to persevere.

My father died early and my uncles thought that my sister should veil, put that {explains touching his face} and hide... the one in Belgrade, mathematics, mathematics in Belgrade. She used to take eggs with her, a box of eggs {explains with his hands}, sausage, to Belgrade. The train was there, the train was a big advantage, scholarship, because my mother had worked on it, because for a woman who did not go to school it was difficult to know that you should sell everything, to sell the land, to sell the stores, you know to sell them like this. She did not pretend to sell it and take the money formally, "I sold it for this much money." And moved on, she did not just sign as if to get a sum of money. So many things, it was a very big sacrifice so that we could study and fulfill my father's amanet, it was a very, a very good thing. I went back a little but these were... things that...

EK It is fine...
AR And I slowly started reading

EK Where did they come from?
AR From Belgrade, in Serbian, Kekec,⁸ [Politikin] Zabavnik,⁹ on Tuesday Zabavnik was published and on Thursday Kekec. Albanians did not read such things, no Albanians did not read such things, Albanians did not read anything. The friends that I had, I feel bad and I love them, my childhood friends never read, they did not even know who Dostoyevsky was or anything. I was influenced by my brothers and sisters, my brother. I was lucky, this was luck, great luck, my brother was an economist, my sister a mathematician, they were all something, Rafet [Rudi]¹⁰ played the violin, the piano, the other sister also played the piano and stuff, she was very weird, we were a strange bunch, in which she [my sister] only worked and read, worked and read, worked and read. They did not work, the kids hung out in the mahalla,¹¹ they did not read, we stayed in the mahalla, hung out in the streets and told tales to one—another, I was ashamed to tell them... what I read, because I read important things, I did not understand them much but I was, I was...

EK Good thing that you had each other at home.

AR We had each other. I started slowly copying those... I used to copy the comics on the window {explains with his hands}. I would copy them on the window, to show how I drew, I could not draw, I really wanted to know how to draw, I would go crazy, I wanted to be the best at something. Because when guests would come he [Rafet] played the violin and I did nothing, this was my childhood. Very, very weird...

EK Is that how you started drawing?

AR I started drawing, also in school, in school. The school was strange at that time, elementary.

EK What did they teach you at

8 Kekec was a Serbian comic magazine, which was first published in 1957. Kekec lasted for 1532 issues and ended in 1990.

9 Politikin Zabavnik was a popular magazine in Serbia, published by Politika Newspapers and Magazines. The first issue came out on 28 February 1939.

10 Rafet Rudi (1949) was born in Mitrovica, Kosovo. He graduated in Conducting and Composition from the Academy of Music in Belgrade. He specialized under the mentorship of the composer Claude Ballif at the National Conservatory of Paris. He is also the speaker's brother.

11 Word of Arabic origin that means neighborhood.

lexu komplet, Dostoevskyn e kom lexu komplet bre une. Gjutha serbe, o Mitrovica s'duhet me ditë gjuhën serbe, kom pasë kojshi serbë unë, qe qeshu i kom pasë {tregon dorë} që sot çuditen njerëzit me a din qysh... Mandej ka pasë sport shumë të madh, na jemi la bre vëlla dhjetë vjeç, unë jom la në bazen, në Kosovë njerëzit nuk kanë ditë çka është bazeni. A po më kupton se krejt këto i ka pru Trepça, krejt këto shkolla, krejt këto... biblioteka, e maj mend si sot, ajo gruja e ka pasë emrin Sadie, u dashke me marrë libra, se s'mujsha me nejtë pa libra. A din kur u lexojke ky libër, ai libër, këta kanë lexu në shpi teme shumë kanë lexu. Aii... Zot, o Zot, të trentë kanë qenë, shumë njerëz me ambicie. Mandej, se kjo ka qenë shumë ndikuese për me arritë ti për me pasë energji.

Mua më ka vdekë baba herët edhe kanë kujtu ata axhët edhe që motra duhet me u fshehtë me qitë ata {tregon me duar ka ftyra} edhe me u fshehtë... kjo në Beograd, matematikën, matematikën në Beograd. Merrke me veti vo, një paketë vo {shpjegon me duar}, suxhuk, në Beograd. Treni u konë aty, ajo u konë përparësi e madhe, treni, stipendioni, se nona ja kish bo hyzmetin, se një gru e pa shkollë vështirë e kanë ditë që duhet me i shitë të gjitha të mundshmet, me e shitë tokën, me i shitë dyqanet, a din sa duhet me i shitë kështu. Jo me i shitë me marrë pare veç formalisht, "E kom shitë kaq pare hajt", sa m'u shkru me tahmin ajo s'i ka marrë ato pare. Domethonë, shumë sende, shumë sakrificë e madhe ka qenë me mujtë me studiu, na me kry amanetin, ajo ka qenë shumë, shumë send i mirë. Se u ktheva edhe pak mbrapa po këto kanë qenë... gjana që...

EK S'ka lidhje...
AR Edhe unë ngadalë, ngadalë fillojsha stripa lexojsha, shumë ato kanë qenë ato stripat. Aty vizatim ishte, stripi ishte vizatim...

EK Prej kahit vishin ato?
AR Prej Beogradit, serbisht "Kekeci",² "Zabavniki",³ të martën

"Zabavniki" dilke, të ejtën "Kekeci". Shqiptarët s'lexojshin asi sende jo, jo shqiptarët s'lexojshin asi sende, s'lexojshin kurgjo shqiptarët. Shokët që i kom pasë po më vjen keq i du të fëminisë kurrë s'kanë lexu as s'e kanë ditë kush është Dostoyevsky as hiç lidhje hiç. Unë prej ndikimit, prej vëllaznive e motrave, vëllau. Kom pasë fat, ky ka qenë fat, fat i madh, vëllau ka qenë ekonomist, motra matematiciente, krejt diçka, ky Rafeti i mëshojke violinës, pianos, motra tjetër edhe ajo u merrke me piano me sende, ka qenë shumë e çuditshme ajo, njëfarë strukture e çuditshme, ajo e cila veç punojke, lexojke, punojke, lexojke, punojke, lexojke. Këta nuk punojshin, nuk lexojshin. Fëmijtë dilshin në mahallë, në mahallë bre në rrugë rrishim qashtu kallxojshim përalla, mu më vike marre me kallxu asi... se çka lexojsha unë, se lexojsha shumë sende të mëdhaja, nuk i kuptojsha shumë po isha, isha...

EK Shumë mirë që e paskët pasë njëri—tjetrin në shpi.

AR Shumë e kena pasë. Edhe fillojsha kadal i kopjojsa ato... i kopjojsa ato stripat në xham {shpjegon me duar} në xham aty kopjojsa, qysh di me vizatu, s'disha me vizatu, qef shumë kisha, mendtë më lejshin kisha qef i pari në diçka me randësi. Se kur vishin musafirët ky [Rafeti] i mëshojke violinës une kurgjo, këto kanë qenë të fëminisë. Shumë, shumë e çuditshme...

EK A qashtu keni fillu me vizatu?
AR Me vizatu, edhe në shkollë, shkollë. Kanë qenë shkolla të çuditshme në atë kohë, fillore.

EK Çka ju mësojshin në atë kohë?
AR Na mësojshin me vizatu, me pikturu në mënyrë perfekte psttt {onomatope}... ajo u konë pedagogjia...

EK Qysh ashtu, realizëm?
AR Po realizëm, pranverën, verën qeto sende. Unë isha jo ma i miri, gjithë i dyti. U konë njoni, njoni një budall bre ai shumë vizatojke mirë (qeshë). Mirë edhe shkojke kadal, kadal, por kjo ngritja e leximit, se leximi të jep sende të mira se ne të folin këta sot gjenerata,

2
Kekec ka qenë një strip, i cili për herë të parë është botuar më 1957. Kekec ka botuar 1532 edicione dhe i dha fund publikimit në vitin 1990.

3
Zabavnik, shtojcë e gazetës Politika ka qenë e popullarizuar në Serbi. Edicioni i parë u publikua më 28 shkurt, 1939.

that time?
AR They taught us to draw, to paint perfectly... psttt {onomatopoeic}... that was the teaching philosophy...

EK What, realism?
AR Yes realism, spring, summer these things. I was not the best, always the second best. There was this one guy, a stupid guy, he drew really well (laughs). OK, so it went slowly, but the reading increased, because reading only brings good things because let this generation say whatever they want today, you talk however you want all day long with a computer, all day long with that, they know a lot of things but they get informed in another way. Reading is irreplaceable, not that I am old—fashioned, I am not, I support new things, I only support new things but it is not about not reading books. I know how they live in America. I was in America many times, I know how life is there, people read books, they also have computers, walkmans, laptops and everything, everything, but they read books, without reading you cannot develop, you partially develop with some information, in my opinion.

EK Did you go to the Shkolla e Mesme e Artit in Peja?¹²

AR No, no, no I was a good student and I went to high school at the best high school in Yugoslavia, each province had its own technical school. The technical school was a technical school, Boris Kidrič was the best technical school in Yugoslavia. There were professors from all over Yugoslavia, engineers, everything, everything, everything. And I, because I could draw and nobody wanted to enroll me at art school, nobody because they had no money, it was hard to go to art school someplace else. We barely took Rafet, the whole family went bankrupt, because he went to high school in Pristina oh God (laughs). And I did not go, I went to technical high school, a very good student, art in my heart, art, art, art, art. I finished technical high school; what I had to do, I had to go to Technical University then, in our family whoever

finished school went immediately to University. To which University? I went to Technical University, I passed all the exams at the Technical University that nobody passed. On the other side I would only paint, I bought the colors...

EK What did you do with those exams then?

AR Nothing...

EK Did you work?

AR No, I came home like a man and I said, "I will not go to the Technical University." You know why I passed all those exams, to show them that I do not mind studying and I am a good student but I don't want to go, I want to study art. The family was a mess, oh God, oh God and yes... I had an understanding with my brother and sister, they were older, my father was not there, my mother did not understand, she did not know, she knew everything but she did not know. So to get me away from that, they sent me, they sent me to the military, they wanted to send me away because do you know how tragic that was for my family, to drop out of university? We were the best students, our family, there was no failing, no...

And I was sent to the military, when I was sent there, I came back from the military, I was definitely not going to go back to the Technical University, but somehow I knew that, I understood that I was not prepared for art school, I was not prepared. I knew that... I said, "You know what? I will go to the Shkolla e Lartë Pedagogjike."¹³ I had another problem somewhere within me: [my siblings] they all studied in Belgrade, I did not want to study in Belgrade. I did not want to study in Belgrade. It was not that, I was not that friendly with Serbs, I was nobody, a zero, but it was a problem, I did not want to live with Serbs, that was how I felt at that age. I did not want to study in Belgrade, all of them, "But we studied there," "You studied there, big deal, I do not want to study there." I did not have anyone abroad so how was I

Shkolla e Mesme e Artit, the Arts High School in Peja was built in 1926 and opened in 1949. The first generations of visual artists in Kosovo received their education in figurative and applicative arts from this institution. This education enabled the artists to continue higher education in arts. The historical building of the Arts High School in Peja was destroyed in August, 2017.

Shkolla e Lartë Pedagogjike, The High Pedagogical School, was founded in Pristina in 1958 as the first institution of higher education in Kosovo. In 1974, the academic staff of the Figurative Arts department of the High Pedagogical School founded the Academy of Fine Arts within the newly established University of Pristina.

ju folni çka të doni gjithë ditën me kompjuter, gjithë ditën me asi, dijnë shumë sende po në mënyrë tjetër qysh e marrin informatën. Të lexuarit është e pazavandësushme, jo që jom i vjetër, s'jom bre unë, i përkrahi sendet e reja, unë vetëm sende të reja përkrahi, por mos me lexu libra nuk është... Unë e di qysh jetojnë në Amerikë, kom qenë shumë herë në Amerikë, e di si është jeta atje. Njerëzit lexojnë libra, e kanë edhe kompjuterin, e walkmanin⁴ e ata, e llaptopin e krejt, krejt, por lexojnë libra, pa lexu libra s'mundësh me përparu, përparon me informata me do sende parcialisht, mendimi jem.

EK A keni shku në Shkollën e Mesme të Artit në Pejë apo?
AR Jo, jo, jo, kom qenë nxanës i mirë edhe po shkoj në shkollë të mesme, në shkollë të mesme ma e mira në Jugosllavi, secila krahinë e asi e ka pasë ka një shkollë teknike. Shkolla teknike ka qenë shkollë teknike bre "Boris Kidriç", shkolla teknike ma e mira në Jugosllavi ka qenë kjo. Ka pasë profesorë prej krejt Jugosllavisë, inxhinera, krejt, krejt, krejt. Edhe unë, se unë disha me vizatu kërkush s'dojke me më çu në shkollë të artit, kërkush se s'kishin pare, zor ishte me shku ti në shkollë të artit dikun tjetër. E çuam këtë Rafetin mezi krejt, bankroti krejt familja, se ky në Prishtinë shkoi në shkollë të mesme, o Zot (qeshë). Edhe unë nuk shkova, shkova në shkollë teknike, shumë nxanës i mirë, në zemër arti, arti, arti, arti, arti. E kryva shkollën teknike çka u dufke me bo, u dufke me shku në fakultet teknik ma përpara, te na në shpi tonë kush e ka kry shkollën u shku menjherë në fakultet. Ku me shku në fakultet? Shkova në Fakultet Teknik, krejt provimet e Fakultetit Teknik i dhashë që kërkush s'i jepke. Knej veç pikturojsha, në shpi pata ble ngjyra...

EK Çka bonet me ato provime mandej?
AR Kurgjo...

EK A keni punu?
AR Jo, erdha si burrat në shpi iu thashë, "Unë nuk shkoj mo në

Fakultet Teknik". A e din pse i kisha dhanë ato provime? Për me iu tregu që unë s'e kom derin e mësimit, por e kom derin që unë jom student i mirë por nuk po du, po du artin me studiu. U bo kushlluz aty në shpi, ai Zot, o Zot, mosvet, kijamet u bo, edhe po... Kisha mirëkuptim me vëllaun e me motrën, ata ishin ma të mëdhej, baba s'ishte, nana nuk kuptojke, nuk dike, dike krejt po s'e dike. Hajde diqysh më largun më çunë në asi, më çunë ushtar, dojshin me më largu me më hekë, se a din çka ishte ajo tragjike për familjen teme, me i lonë studimet? Ne ishim bre vëlla studentat ma të mirët bre shpija jonë s'kishte mos me kalu, mos me...

Edhe m'çunë ushtar, kur m'çunë ushtar, erdha prej ushtrisë. Defintivisht ajo s'kom me shku mo as në teknikë, po e disha se, e mësova s'di qysh e mësova që une nuk jom i përgaditun për fakultet të artit, nuk kisha ngritje une, nuk kisha shkollë po deri sa e morra vesh. Unë e disha që... edhe thashë, "A din çka? Kom me shku në Shkollë të Lartë Pedagogjike". E kisha edhe një problem une dikun në veti, krejt këta kishin studiu në Beograd, unë s'dojsha me studiu në Beograd. S'dojsha me studiu në Beograd. S'ishte ajo une, s'isha unë, s'kisha miqësi me popullin serb as s'isha kërkushi unë, zero, por ishte një problem, unë s'dojsha me jetu me serbë, shumë e ndijsha unë veten në atë moshë. Në Beograd s'dojsha me studiu, krejt këta, "Po na kena studiu..." "Ti ke studiu, po punë e madhe, unë s'du me studiu." Ku me studiu jashtë? Kërkon, s'e kisha një njeri. Atëhere m'jshe me shku jashtë, por kërkon s'e kisha, një lidhje, dikon, a naj axhë a najsen, a dikon, ja, ja, ja. Shkova në Shkollë të Lartë Pedagogjike në...

EK Në Prishtinë.
AR Në Prishtinë. Edhe aty m'u çelën sytë, shkollë ma të mirë, unë kom punu shumë vjet në Akademi, pedagogji ma të mirë, shkollë ma e mirë, ma si duhet, arsimtarë si duhet. Akademia e sodit ku kom punu, ku kom punu unë, as deri te thoni {shpjegon me duar} s'munet

4
Ang.: Walkman, mjet për dëgjimin e muzikës në formatin e kasetave, sot ekuivalent i tij është ipod—i.

supposed to study there? At that time you could go abroad. But I had no connections, a paternal uncle or someone, no one. I went to the Shkolla e Lartë Pedagogjike in...

EK In Pristina.

AR In Pristina. And there I was enlightened, it was the best school, I have worked at the Academy for many years, the best pedagogy, the best school, it was as it should be, the teachers were as they should be. Today's Academy where I worked, not even close, it cannot compare to the pedagogy of the Shkolla e Lartë. I mean it.

EK In which years?

AR '72—'73, '71, 2, 3... to be honest, I do not know exactly...

EK How many years did it have, five?

AR What?

EK The Shkolla e Lartë Pedagogjike?

AR Two. I just wanted to prepare myself for the Academy. My dreams, everybody has dreams, you have dreams too. My dream was, Agim Rudi, student at the Academy of Arts. This was my dream, but not in Belgrade, somewhere abroad, I could not go abroad so I went to the Shkolla e Lartë Pedagogjike to prepare for [art school]. You could not just go like that, I encountered something extraordinary there. You know here, throughout our lives we did not have a good life quality, for example I finished the Technical School in Serbian, in Serbo—Croatian, I only had Albanian in the Albanian language course, nowhere else.

EK What sort of preparation did you get from the Shkolla e Lartë Pedagogjike?

AR Very good, very good. For me basic knowledge and then great knowledge as well, with which I could freely go to any academy in the world, anywhere in the world with the people who were there. Who were they? Muslim Mulliqi,¹⁴ Tahir Emra,¹⁵ Rexhep Ferri,¹⁶ etc., etc., etc.

EK So you went to the Shkolla e Lartë Pedagogjike Department of Figurative Arts, at a time when there were...

AR Yes... yes...

EK So you're talking about that school, okay I know now.

AR It is not very well known, it was outside of...

EK This was before the University was established?

AR Before... the University was not...

EK Yes, yes, I understand... What did you learn there?

AR Just like in the Academy, drawing, painting, sculpture. Eh, something else that's very important for me is that I knew I was going to study sculpture. Just do not ask me why. I do not know. Was I influenced by this, or that? I always had a dream, Michelangelo, everything I read was about Michelangelo. These were some beginnings for me, construction engineering left you with a discipline of its own, maybe drawing, the drawing was technical. This is why I accepted the Technical School, I accepted art and there was some drawing at the school, if nothing else it was called drawing.

EK Where did you read these, also this about Michelangelo was probably literature in Serbian language

AR I always, always knew Serbian perfectly...

EK They were more developed?

AR Much, much, much, much, Serbs were much more developed. There was nothing here, and... so I came to the Shkolla e Lartë. Besides all of the good things that I found at the Shkolla e Lartë, it had a pedagogical framework, it prepared intellectuals very well, very, very. I was their colleague, I did not know their worth then, I now know how valuable those people were, as professors. They helped develop a whole country, you cannot develop without art, nothing, without art, without arts.

I found something very important there, I contacted, I started, the professor of sculp-

14
Muslim Mulliqi (1934—1998) was born in Gjakova, Kosovo. He was an impressionist and expressionist painter from Kosovo. Born into a family of artists, Mulliqi attended the Academy of Fine Arts in Belgrade under Zoran Petrović's mentorship, where he also continued with his postgraduate studies.

15
Tahir Emra (1938) was born in Gjakova, Kosovo. He is an Albanian modernist painter. Emra is a member of the Academy of Sciences and Arts of Kosovo.

16
Rexhep Ferri (1937) was born in Kukës, Albania. He is a renowned Kosovo painter. Ferri attended the Academy of Fine Arts in Belgrade. In 1999 he was elected secretary of the Art Section of the Academy of Sciences and Arts of Kosovo and in 2000 he was elected as a regular member.

- me ju afri pedagogjisë së Shkollës së Lartë. Këto po e thom me plotë gojë, kështu.
- EK Cilat vite këto?
AR '72 '73, '71, 2, 3... s'e di saktë me të kallxu drejtë...
- EK Sa vite i ka pasë, pesë?
AR Kush?
- EK Shkolla e Lartë?
AR Dy, unë dojsha veç m'u përgaditë për me shku në Akademi. Andrrat e mia, gjithkush i ka andrrat, edhe ju i keni andrrat. Andrra jem ka qenë, Agim Rudi student i Akademisë së Arteve. Qe qekjo ka qenë andrra jem, po veç jo në Beograd dikun jashtë, jashtë s'u bojke edhe hajt shkova në Shkollë të Lartë për m'u përgaditë unë, se ti s'mujsh me shku hajt. Atje takova diçka të jashtëzakonshme. A din, te na gjatë jetës nuk kena taku jetë kumedit çfare, për shembull në Shkollën Teknike në serbisht e kom kry, në gjuhën serbo—kroate, veç shqip kom pasë në gjuhën shqipe, kurgjo tjetër.
- EK Çfarë përgaditje ju dha Shkollja e Lartë Pedagogjike?
AR Shumë të mirë, shumë të mirë. Edhe për mu njohuri elementare, mandej edhe njohuri shumë të mëdhaja me të cilat unë mujsha me shku lirisht në Akademi ku të du në botë, ku du në botë me ata njerëz që kanë qenë. Kush kanë qenë? Muslim Mulliqi, Tahir Emra, Rexhep Ferri, e tjerë, e tjerë, e tjerë.
- EK Ah, ju keni shku në Shkollë të Lartë të Artit Figurativ kur s'ka pasë...
AR Po, po de.
- EK Ah, për atë shkollë jeni tu fol.
Okej, po p'e di.
AR Kërkush s'e lavdon shumë, ka qenë e jashtëzakonshme.
- EK Kjo është para se me u formu fakulteti?
AR Para... s'ka qenë fakulteti...
- EK Po, po, p'e kuptoj. E çka mësojsh aty?
AR Si në Akademi, vizatim, pikturë, skulpturë. Eh, edhe diçka për mu shumë e rëndësishme unë e kom ditë që kom me studiu skulpturën. Veç mos më vetni pse, s'e di. A ka qenë
- ndikimi i kësaj apo asaj. Unë gjithë një andërr e kom pasë Michelangelon, krejt ato çka i kom lexu për mu ka qenë Michelangelo. Për mu këto jonë konë do fille, do sende, diçka ndërtimtaria ka lonë të vetën atë diciplinën, ndoshta vizatimin, vizatimin ai ka qenë teknik. Pse unë s'e pranojsha shkollën teknike bre, unë e pranojsha artin në ato kishte pak diçka vizatim, mos kurgjo tjetër emri ishte vizatim.
- EK Ku i lexojshit këto, po mendoj edhe kjo për Michelangelon me siguri ka qenë literaturë në gjuhën serbe?
AR Gjithë, gjithë unë e kom ditë serbishten perfekt.
- EK Ata kanë qenë ma përpara, apo?
AR Shumë, shumë, shumë, shumë, serbët kanë qenë shumë përpara. Te na s'ka pasë kurgjo, edhe... Kështu që, erdha te Shkolla e Lartë. Shkolla e Lartë përveç krejt të mirave që i gjeta aty, ka qenë kuadër pedagogjik, intelektualë të përgaditur për këto shumë, shumë. Me ta mandej kom qenë kolegë une, po vetëm une s'e kom ditë vlerën njëherë, unë tash e di çfarë vlere e kanë pasë ata njerëz, si njerëz si pedagogë. Ata një popull e kanë çu përpara. Pa art nuk shkohet përpara, as shtet, as kurgjo, pa art, pa arte.
- Aty gjeta një gjë edhe shumë të rëndësishme, une kontaktova, fillova, profesori i skulpturës ishte Agim Çavdarbasha edhe unë u bona shok me to, në të vërtetë ai u bo shok me mu, se une isha student. Por ai lejojke kështu. Unë isha ma i pjekun, pak kjo një vjet e këto teknika e këto m'i morrën një vjet, e ushtria dy vjet m'i morrën e u bona ma i vjetër diqysh. U bona ma i vjetër s'isha ma krejt shumë i ri. Edhe... ai i dojke njerëzit serioz, kështu që ishin me qëllime të caktume, une i thashë, "Agim, profesor Agim une kom me studiu skulpturën, kom me studiu dikun jashtë skulpturën, unë kurgjo nuk di, kurgjo nuk di, zero, unë jom zero".
- Aty vishin në Shkollë të Lartë njerëzit me Shkollë të Mesme të Artit. A din qysh vizatojshin

ture was Agim Çavdarbasha¹⁷ and I became his friend, actually he became my friend, because I was the student. But he allowed, I was more mature, the Technical School and these things took me a year, two years in the military and I somehow got older. I got older because I was not all that young anymore. And... he liked serious people who had set goals, I said, "Agim, Professor Agim, I am going to study sculpture, I am going to study sculpture somewhere abroad, I do not know anything, I do not know anything, nothing, nothing."

People with an art middle school education came to the Shkolla e Lartë. Do you know how they drew, like God, like God draws, God. They were very good, but something happened there that Albanians never, never say that they do not know. I happened to be that guy who tells people, "I do not know, I do not know, I came to learn. I came to learn bre."¹⁸ What have I come to learn? I did not know the great method {explains with his hands}, [change perspectives] to see the big wallet. Now I know how to do those [techniques]. I looked at them, op, op, op, op {onomatopoeic}.

I became the best student in the first year of Shkolla e Lartë Pedagogjike. The best, I took my mother, because I was living with my mother, because they all were, Rafeti was studying, my other brother got married and had another house, I was alone with my mother. I took my mother with, I rented a house and left the house in Mitrovica and went to study at Shkolla e Lartë. I could not explain it to people because they did not understand, they thought something else had happened. And I was focused on school because I had set my mind to go somewhere. Then I became friends with Agim Çavdarbasha, I went to his atelier, I learned how to do portraits. There was professor Tahir, he taught us painting, oh God, oh God bre! I would tell him, "Professor, I am going to study sculpture." He did

not even ask me if I wanted to study sculpture, I was scared somebody will take it away from me... stop me from studying sculpture.

It was very crucial, it is a small detail, one time myself, Agim Çavdarbasha and Svetomir Arsić,¹⁹ who was a professor of sculpture, very good at sculpture. Huge nationalist, when Milošević came, he spoke in Niš in the world's biggest meeting, the biggest that Serbia had, in Milošević's time. That, that professor of sculpture. And I do not know how with him, because I was friends with Agim and he said, "Come on Arsić." Arsić said, "Agim will you come to Mitrovica?" "Why?" "Come," he said, "we are going to see Hasan Prishtina."²⁰ A Serb did the sculpture of Hasan Prishtina...

EK The sculpture? The statue?
AR The Hasan Prishtina statue. I almost had a heart attack, almost went mad. I dreamt of how I will be a sculptor, how I will do the sculptures, not Arsić. Arsić was a great sculptor, but also a great nationalist and I had reached, I had reached the point where I understood that sculpture has nothing to do with those trivial things. Art cannot be mixed up with those small things, it has nothing to do with them and this is what I tried to show in those days.

EK Was it true for everyone that art and politics did not mix?
AR Not me, not me.

EK The rest?
AR If Arsić was good, Arsić is good, that is it! There's no one, but I could see a lot of stuff, I tried to be fair with myself you know, pure, at peace, and... I learned a lot from these professors, but the theoretical part was taught less in Shkolla e Lartë, then the pedagogical part was taught more, more time is spent on the pedagogical part and on art techniques, than on aesthetics; I knew I was lacking something. It seems that they lacked that, but not me because I knew exactly what that was; I didn't know how to call it. I saw a lot, I looked at a lot, but I still hadn't decided what

17 Agim Çavdarbasha (1944–1999) was born in Pejë, Kosovo. He was a Kosovo Albanian sculptor who graduated from the Academy of Applied Arts of Belgrade and the Academy of Arts of Ljubljana. Çavdarbasha was a major influence on contemporary sculpture in Kosovo. He was a member of the Academy of Figurative of Arts of Kosovo and later of the Academy of Science and Arts.

18 Colloquial: used to emphasize the sentence, it expresses strong emotion. More adds emphasis, like bre, similar to the English bro, brother.

19 Svetomir Arsić—Basara (1928) was born in the village of Sevce, Kosovo. He is a Serbian sculptor and storyteller. In 1958, he graduated from the Academy of Applied Arts in Belgrade, under Rade Stanković. Arsić was a member of the Academy of Sciences and Arts of Kosovo, and was widely known in Yugoslavia for his war monuments.

20 Hasan Prishtina (1873–1933) was an Albanian politician, known as Hasan Berisha before he became the Prishtina delegate to the Ottoman Parliament. He led the 1912 uprising in Kosovo against the Young Turks and after the declaration of independence of Albania he held several posts in the Albanian government including the one of Prime Minister. He was assassinated in Thessaloniki on the orders of King Zog.

ata, si Zoti bre, Zoti qysh viza-
ton, Zoti. Ata ishin shumë të
mirë, po veç aty ndodhshin
diçka, aty shqiptarët kurrë s'ka
që, kurrë nuk thojnë që nuk di.
Unë pata qëllu njerëzve që ju
thojsha, "Nuk di, nuk di, jom
ardhë me mësu. Jom ardhë me
mësu bre". Çka jom ardhë me
mësu? Nuk disha bre unë aktin
e madh {shpjegon me duar},
me pa kuletën të madhe. Nuk
di more me i bo unë ato. I kqyr-
sha ata, op, op, op, op {ono-
matopeike}.

Vitin e parë u bona student ma
i miri në Shkollë të Lartë Peda-
gogjike. Ma i miri krejt, e pata
marrë nanën, se me nanën
isha jetojsha se krejt këta ishin,
njeni në studime Rafeti, ky vël-
lau tjetër ishte martu kishte
bo shpi tjetër, veç me nanën.
E mora nanën, e mora një shpi
me qera e lashë shpinë në Mi-
trovicë edhe shkova me studiu
në Shkollë të Lartë. S'muj-
sha me ju spjegu njerëzve se
njerëzit nuk kuptojshin, kujto-
jshin që diçka tjetër ka ndodhë.
Edhe u përqendrova krejt në
Shkollë të Lartë se unë e kisha
mendjen qysh kom me shku
dikun. Mandej me Agim Çav-
darbashën jom shoqnu, kom
shku te ai në atele fillova kadal
ja nisa me bo portret, mësova
me bo portret. Ishte profesori
Tahir, na mësojke pikturën bre
o Zot, o Zot bre! Po s'ka ma të
mirë profesor në jetë, s'ka ma
të mirë hiç kërkun nuk ekzis-
ton bre. Po i thojsha, "Profe-
sor, unë kom me studiu skulp-
turën", pa më vetë, "Skulpturën
kom me studiu", u tutsha që po
ma merr dikush, po ma... s'po
m'len me bo skulpturën.

Ka qenë shumë vendimtare
ndoshta është detal i vogël,
njëherë unë e Agim Çavdar-
basha edhe Svetomir Arsić⁵ ka
qenë profesor i skulpturës, në
skulpturë shumë i mirë. Nacio-
nalist shumë i madh, kur o ard-
hë Miloševići ai ka folë në Nish
në një miting ma të madhin në
botë, ma të madhin që ka bo
Serbia e Miloševićit. Ai, ai pro-
fesor, ai i skulpturës. Edhe me
te na s'di qysh, se e kisha shok
une Agimin edhe ai tha, "Hajde
Arsić", Arsići i tha, "Agim a po
vjen deri në Mitrovicë?" "Pse?"
"Hajde," tha, "po shkojmë me
kqyr Hasan Prishtinën," serbi e

EK
AR

kishte bo Hasan Prishtinën...
Skulpturën, bustin?
Bustin e Hasan Prishtinës.
Gati m'ra pika, gati u tranova.
Andërr shihsha natën qysh
kom m'u bo skulptor, qysh kom
m'u bo skulptor, mos m'i bo Ar-
sići. Ai Arsići shumë skulptor i
mirë edhe... po veç nacionalist
shumë i madh edhe unë veç
pata arritë, isha në moshë kur
e kuptojsha, çka arti s'ka lidh-
je me asi sende të vogla, arti
s'përzihet me ato sende të vog-
la, s'ka lidhje kështu u mudoj-
sha me tregu une në atë kohë.

EK
AR

A ka qenë ashtu që artin nuk e
keni përzi me politikë?
Unë jo, unë jo.

EK
AR

E tjerët?
Në qoftë se ka qenë Arsići i
mirë, Arsići është i mirë, tung-
jatjeta! S'ka, por veç i shihsha
shumë sende, u mudojsha
me qenë fer me vetëvetën a
din, i pastër, në paqë, edhe...
Shumë kom mësu prej këtyre
profesorëve, po pjesa teorike
pak mësohet edhe në Shkollë
të Lartë atëhere ma shumë
mësohet pjesa pedagogjike,
ma shumë harxhohet kohë në
pjesë pedagogjike edhe në
teknikë të artit, sesa në pjesën
estetike. Unë e disha që diçka
po më mungon mu. Si duket
ktyne ju ka mungu, por jo mu,
se unë s'e disha bash çka është
ajo, unë s'ia disha emrin asaj.
Une shihsha shumë, shiqoj-
sha shumë, po hala s'i kisha
vendosë sendet: çka është
abstrakte, çka është realiste?
Hala s'i kisha vendosë sendet
zi e bardhë, hala nuk i disha
përgjegjet. E shihsha unë që
mu, që më vynë mu shkollë
apet, e shisha po s'ma spjego-
jshin mu këta. Këta e dishin,
deri dikun e dishin, deri dikun
se edhe kjo ka qenë gjeneratë
që menxi u shku në Beograd,
menxi u pranu, menxi asi... Ka
qenë problem me studiu në
Beograd bre.

EK
AR

Qysh jeni profili estetikisht,
qysh e keni definu për vete?
Instiktivisht, si lopa (qeshin).
Po më vjen keq që po foli, nuk
e kom përgjegjen. S'e di! Unë
e kom ditë që ka edhe diçka
mas. Gjatë ndërtimit të një ve-
pre artistike ekzistojnë shtresi-
met, ekzistojnë... Po tash i
di, atëherë s'i kom ditë, veç e

5
Svetomir Arsić—
Basara (1928)
u lind në fshatin
Sevce, Kosovë. Ai
është skulptor dhe
narrator serb. Më
1958, ai diplomoi
nga Akademia e
Arteve Aplikative në
Beograd, me mentor
Rade Stanković. Arsić
ka qenë anëtar i Aka-
demisë së Shkencave
të Kosovës, dhe ka
qenë shumë i njoftun
në Jugosllavi për
monumentet dedikuar
të rënëve në Luftën e
Dytë Botërore.

that abstract thing was, what was real, I still haven't distinguished what was black and what was white, I still didn't have the answers. I could tell I needed more knowledge, I could tell but no one explained things to me. They knew, to some degree they knew, to some degree because this too was a generation that barely went to Belgrade, barely got in, barely that. It was a problem to study in Belgrade, really.

EK How did you define your aesthetics, how did you define it for yourself?

AR Instinctively, like a cow (laughs). I'm sorry I'm saying this, I don't have the answer. I don't know! I knew there was something beyond this. During the production of an artistic work there are layers, there are... but now I know, I didn't know them back then, I just knew there is something else, there is something else that I should know as a sculptor, that the artist should know in order to create great works. It cannot be done by God. I was spunky as a child, the artist expects from God, he comes up with nothing {explains with hands} and... I see here, I go mad when I watch television, X singer comes on, uncultivated X that knows nothing, aesthetically of course not, doesn't know anything about music, and says, "I have a project and may it be God's will to finish my project as I plan to." A bad song, stupid. It is not based on anything, but that is not how music works, rap music doesn't work like that, no artistic work, nothing is built up like that.

At Shkolla e Lartë I paid close attention to what they were saying, and I got many answers, they were really good professors, really good, but not all of them, they left a gap. The professors kept a distance, they taught you a lot, they taught you a lot. It was really good but they maintained that distance between them and the students, and students should not be exposed to that distance, not in art, you need more than... Like, Agim Çavdarbasha did not, Agim did not, he created friendships.

And so I tried, I tried to do the same thing when I became a professor, whomever that wanted to talk to me could have done so, they could have called me whenever, even in the middle of the night and say, "I have a dilemma." But you know what that means, you save someone's life, you do, they don't know, they don't know. They don't know, you can't just read, you can't learn art by reading it. You can learn other things, but I don't know how to explain a painting, they don't know, they don't know where its secret is, not that you're good at it, I know it all today. Today, I know everything, there is nothing to which I don't have an answer, not that like...

EK Did your exhibitions help you receive some sort of feedback or support related to your work?

AR But I couldn't, I couldn't understand the exhibitions, students don't understand the exhibitions a lot today, they read into the exhibition, but they don't know.

EK No, no, when you did your exhibitions, did you do exhibitions while you were in Shkolla e Lartë and did you receive any comments or something to help you understand what you were doing?

AR Not many, not many, not many.

EK Not many...

AR They were decent teachers... but did not give the finishing touches to help you accomplish yourself. I have the impression that aesthetically, aesthetic learning isn't done much, not done much, there, there, I think after years of learning, that was the problem.

EK How did you come in contact with art, I am interested to know, were there any exhibitions, were there, how was cultural life organised?

AR Later on, I will tell you about that later on when I get to Ljubljana Academy, it's where I finished my Shkolla e Lartë.

EK And for Pristina, would you be able to tell us what kind of cul-

- kom ditë që edhe diçka është, edhe diçka është që duhet me ditë unë skulptori, artisti me ditë për me mujtë me bo vepër të mirë. S'mundet me u bo hajde prej Zotit. Gjithë i kom pasë inat prej fëminisë, artisti pret prej Zotit, ai ia bjen {shpjegon me dorë} edhe... I shoh këtu, tranohna kur i shoh në televizion, del kangëtari X i pangritun që s'din kurgjo hiç, estetikiisht sigurisht, as muzikë kurgjo s'din, edhe thotë, "E kom një projekt edhe qysh e ka dhonë Zoti m'jep fuqi do të realizoj si duhet projektin". Nji kangë të keqe, palidhje. E cila s'ka kurrëfarë baze, por muzika nuk ndërtohet ashtu bre, as repi nuk ndërtohet ashtu, as kurçkafi nuk ndërtohet ashtu, asnji vepër artistike asnji send nuk ndërtohet ashtu.
- Unë edhe në Shkollë të Lartë i ndëgjojsa shumë, se merrsha përgjegjen shumë, këta kanë qenë profesorë të mirë, shumë të mirë, por jo gjithë, i kanë lonë distancë. Profesorët kanë lonë distancë, kanë mësu shumë, shumë kanë mësu, shumë kanë mësu. Shumë ka qenë mirë, po e kanë lonë mes studentit, studentit s'bon me i lonë distancë të madhe, në art jo, duhet ma shumë se... qe Agimi jo, Agimi jo, ai ka kriju shoqni. Unë mandej e kom provu të njejtën gjë e kom provu kur jom bo vetë profesor, kush ka dashtë ka mujtë me bisedu me mu bre, kur dush në gjysmë të natës ka mujtë me thirrë me më thonë, "E kom një dilemë bre". Po çka domethonë bre ajo, ia shpëton njerit shpirtin ia shpëton, nuk e din, nuk e din. Nuk e din, s'mundet me marrë hajt e lexoj, nuk mësohet bre arti, po e lexoj. Sendet tjera mësohen, po s'po di me spjegu nji pikturë, nuk din, nuk e din ku është fshehtësia, jo që je bo Zot, sot i di vlla une. Sot i di çdo gja, s'ka send që s'kom përgjegje, jo që a din kështu...
- EK A ju ndihmojshin ekspozitat me marrë njëfarë lloj përgjegje edhe mbështetje rreth punës suaj?
- AR Po s'mujsha, s'mushja me i lexu ekspozitat. Sot studentat s'mujnë shumë me i lexu, shkojnë me lexu nji ekspozitë nuk din.
- EK Jo, jo, ju kur ekspozojshit edhe a ekspozojshit sa keni qenë në Shkollë të Lartë edhe a merrshnit ndonjë lloj komenti a diçka që ju ndihmojke me kuptu çka jeni tu bo?
- AR Jo shumë, jo shumë, jo shumë.
- EK Jo shumë...
- AR Ishin pedagogë të mirë, por jo atë ramjen e fundit për me të ndihmu komplet. Kom përshtypjen që aty te estetika, te mësimi estetik nuk është bo shumë, nuk është bo shumë, aty, aty, unë mendoj mas sa vjete arsim, aty ka qenë problemi.
- EK Si vishit në kontakt me art po më intereson, a ka pasë ekspozita, a ka pasë, si ka qenë e organizime jeta kulturore?
- AR Ma vonë, ma vonë ju tregoj ma vonë kur shkoj në Akademi të Lublanës, këtu e kryva unë Shkollën e Lartë.
- EK Po për Prishtinë, a kishit ditë me na tregu çfarë jete kulturore ka pasë atëhere?
- AR Po e di, kur kthena prej Lublanës ju tregoj.
- EK Okej.
- AR Se ma mirë e di atëhere, tash s'disha, nuk isha unë ai që di me tregu. Unë veç po ju tregoj qysh kom kalu nëpër faza. Këtu mësova, mësova vlla, mësova, vizatim, mësova me bo portret. Mësova të gjitha sendet të cilat vyjke unë me u përgaditë m'u pranu në Akademi tjetër, edhe dikush fshehtas... ky Agimi e ka pasë shkallën e tretë e ka kry në Lublanë. Natyrisht... në Akademi, këta në Beograd e kanë kry këta Akademine e Arteve, por masterin shkallën e tretë e kanë kry në Lublanë. Edhe ushtar unë isha në '68—'69 në Kranj, në Slloveni. U bo. Ia nisi konektimi me Slloveninë dyqysh, shkova une kapak, s'e disha hiç, nuk isha i vetëdijshëm. Agimi më spjegojke. Ai ka pasë edhe grunë përpara e ka pasë Agimi sllovene, rrisha edhe une me shoqni, me ata të Shkollës së Lartë rrisha shumë. Kom mësu shumë prej Agimit.
- AR Pjesa e Dytë
- AR Edhe, e kisha nji mundësi m'u pranu nëpër këto... në Slloveni

AR tural life it had back then...
Yes, I know, when I come back from Ljubljana I will tell you.

EK Okay.
AR I will know better how to explain when I come back from [Ljubljana], now I don't know, I wasn't the one who knew how to explain. I am just telling you how I went through stages. Here I learned, I learned, learned, drawing, I learned how to make a portrait. I learned everything that was needed to prepare to get accepted into the Academy, and someone secretly... this Agim had received his masters from [the University of] Ljubljana. Naturally... at the Academy, this one in Belgrade has finished at this Academy, got a Master's degree in Ljubljana. And I was a soldier in '68—'69 in Kranj, Slovenia. Connections with Slovenia began somehow, I was there shortly, I had no idea, I wasn't aware. Agim would explain he was there with his wife, his first wife was Slovenian, I would stay there with friends from my Shkolla e Lartë, I hung out with them a lot, I learned a lot from Agim.

Part Two

AR And, I had a chance to get admitted to those... In Slovenia it was impossible; I knew the situation, they don't accept 150 Albanians here, they had schools only for Slovenians and eventually they accepted Macedonians. Because Macedonians in former Yugoslavia weren't really problematic, they lowered their heads and had it well. Even when they became a state they had no problems, they didn't win it with war, those are Macedonians but I am connecting different topics, but this is how it was. And I had a chance, Agim could help me there with the Master's degree... therefore... since he was there he knew the situation better to help me a little but I said, "No, forget about it!" {claps}. And I left and got those, I got what I needed for the entrance exam, four portraits were needed, ten drawings, and I began drawing portraits... now I knew how to

do portraits. Do you have any idea what I used to draw? Deçan and a house and one of those {explains with hands}, I didn't know anything, before I knew nothing, before but now I was in a totally different situation.

I did four portraits of the level... a few classes were for sculpture, Agim Çavdarbasha had just come to the Academy, and I did those portraits. I bought a nylon sponge, a huge sponge and I did two here, two there {explains with hands}, two sculptures with you know, two sculptures with you know, I got the drawings, I got in. It was the train that goes to Ljubljana, in Fushë Kosova at 11AM, I went there like that, I hopped on the bus and went to Fushë Kosova, and hopped on you know, and went to Ljubljana. A good thing was that I had money, the situation in my family was perfect, everything, Rafeti had come back from...

EK Belgrade...
AR From Belgrade, he started working at the Academy immediately, his salary was thousands of marks which were a lot 40 years ago. 40 years and more, before 44 years, it was long time ago, we had money at home... I said I wanted to study, we didn't always have money, we all had our financial problems. With no problem I went there, all my sisters, all of them sent me money, džeparac,²¹ I went but didn't know where, I didn't know, I was in Ljubljana, I didn't know anything. I went, God...

I entered the exam, five days of entrance exam then, seriously, a lot of people, a lot of people, and I were wrongly informed, Slovenian wasn't similar to Albanian [he means Serbian]. Slovenian was a different language, not, not even people know that, today people don't know and think that Slovenian is the same, no Slovenian is not the same, Slovenian is a totally different language, I had no clue. I would brag that I knew Serbian, that was a limitation, in Slovenia you're limited if you speak Serbian, and it's true...

21
Serb: džeparac,
literally means pocket
money.

ni ishte e pamundun, e disha unë situatën, 150 vetë ata s'i marrin shqiptarë bre. Ata i kanë shkollat për sllovenë, eventualisht për maqedonë i kanë. Se maqedonët në ish—Jugosllavi s'kanë qenë shumë problematik, ata e kanë ulë kokën edhe gjithë kanë kalu mirë. Edhe shtet kur u bonën pa kurrëfarë problemi, ata s'jonë bo me luftë shtet, këta janë maqedonët, po i lidhi [temat], por qeshtu është. Edhe kisha një mundësi diqysh me m'ndihmu Agimi për atje në shkallë të tretë... atje për... masi ka qenë atje e ka njoftë situatën me m'ndihmu pak, por thashë, "Jo bre lene" {përplasë duart}. E jom nisë te kom marrë ato, te kom marrë çka duhet për provim pranues, u duhshin katër portrete, dhjetë vizatime kështu, t'ia kom nisë me bo portrete... tash disha me bo portrete. Përpara a din çka pikturojshta bre? Deçanin me një shpi edhe me një asi bre {shpejgon me duar} kurgjo s'disha bre, kurgjo përpara, përpara... por tash isha në një situatë krejt tjetër, tash disha.

I bona katër portrete të nivelit sa u... se pak orë ishin të skulpturës, sa kishte ardhë Agim Çavdarbasha në Akademi, edhe i bona ato. E bleva një syngjer të najllonit, syngjer të madh, i bona dy këtu, dy këtu {shpejgon me duar}, dy skulptura me një asi, dy skulptura me një asi, i morra vizatimet, hypa [në tren]. Ka qenë treni për me shku në Lublanë, në Fushë Kosovë në 11:00 sahati ka qenë, jom shku qashtu, jom hyp në autobus, jom shku deri në Fushë Kosovë, jom hyp n'asi [tren], jom shku në Lublanë. Qajo e mirë është që kisha të holla, situatën në familje e kisha perfeksion, krejt, Rafeti ishte kthy atëherë prej...

EK Beogradit...
AR Prej Beogradit hini në punë, në Akademi menjherë, e kishte rrogën njëmijë euro, njëmijë marka, rroga ishte njëmijë marka, a din çka ishin njëmijë marka n'atë kohë para katërdhjetë vjete. Para katërdhjetë e sa vjete, para 44 vjete, shumë moti more ajo, kishim n'shpi pare, kurrëfarë... unë u nisa

thashë, "Du me studiu." "Agim, veç shko studio. Kënaqu!" Hiç kurrëfarë problemi une, kurrëfarë problemi. Se gjithë shqiptarët, na kurrë, gjithë s'kena pasë, gjithë kena pasë probleme materiale. Pa kurrëfarë problemi jom shku, krejt motrat, krejt më çojshin pare, d'zeparac⁶, shkova po s'disha ku, s'disha, isha në Lublanë, s'disha kurgjo. Shkova, aiii Zot...

Hina në provim pranues, pesë ditë provim pranues atëherë, shumë seriozisht, shumë vetë, shumë vetë. Mandej gabimisht e kisha informatën, sllovenishtja nuk i përngajke shqipës [mendon me thënë serbishtes]. Sllovenishtja ishte tjetër gjuhë bre, as, as njerëzit nuk e dijnë, as sot njerëzit nuk e dijnë, kujtojnë që sllovenishtja është njësoj, jo bre sllovenishtja nuk është njësoj, sllovenishtja është krejt tjetër gjuhë bre, lidhje s'kisha. Tani une u mburrsha me ata që e di serbishten, ajo ishte hendikep, në Slloveni ishte hendikep me ditë serbishten bre, kjo ishte e vërtetë edhe...

EK Qysh ke provimi pesë ditë, po mendoj...
AR Pesë ditë...

EK Ditën e parë ishte...
AR Ditën... njëherë vizatojshim, mandej bojshim portret, mandej bisedojshim, komisioni, një komision e kur, në fund domethanë u mbledh një komision prej shumë vetë dhe na pyten, "Pse po studion, e pse po donë me studiu, e pse kështu..." Unë e kisha bo një llapsus shumë t'madh. Une e kisha diplomën e Shkollës së Lartë, une hiç, une e kom çu, por ata s'e kanë pa pse po e çoj. Une për vitin e parë jom shku, e tash ata vetën, "Kena një problem, ti e kishe kry Shkollën e Lartë," e m'thanë, "Ti mundesh në qoftë se donë, ti u duftë me na tregu. A po donë për vitin e dytë, a për dytin e tretë a?" "Jo," i kom thonë, "une s'po du as për vitin e dytë as... unë nuk e di skulpturën. Jom ardhë për vitin e parë." Ai ishte, ai ishte, ata s'kishin ndi kësi fjalë kurë në jetë, o budalla, unë isha shku me mësu skulpturën bre, s'më interesojke kurgjo, hiç

6
Serb: d'zeparac,
shuma mujore të të
hollave, jo medomos
shuma të mëdha,
para xhepi.

EK What was the five-day exam like... I mean...

AR Five days...

EK The first day was?

AR During the day... we would draw, and then make portraits and discuss, commission, a commission and where, at the end there was a commission with a lot of people and we were asked, "Why are you studying, why do you want to study this, why this..." I had made a big mistake. I had my Shkolla e Lartë diploma, I sent it, but they didn't understand why I sent it. I went there for the first year and now they said, "We have a problem, you finished Shkolla e Lartë" and they told me, "You can if you want, you should have told us. You want to enroll in the second or third year?" "No" I told them, "I don't want to enroll neither in the second year, nor... I don't know sculpture. I am here to enroll in the first year." He was, he was, they had never heard these words before in their lives, what a fool, I was there to learn about sculpture, I didn't care about anything, I cared about nothing at all.

I went there, this was very important, it was very, very, very important. At the time that seemed pointless to me, big deal, as if... I only cared about how to get into the Academy. I got in, perfect. They sent a telegraph, a friend, a guy because there were some Albanian students there, one from Gjakova, all the students, not many in Ljubljana, a hundred students. So this guy, Fahri Xharra is, he is constantly on Facebook, Fahri Xharra there, he studied textile. He sent it, wrote it, I told him, he sent the telegraph, "You got in." I went crazy, I went crazy, I went crazy and then I told Agim Çavdarbasha, oh my God he was so happy, he was so happy that I didn't ask for help. You know why? Because he said, "I would have helped you, but you would be left a cripple." You understand? These were the little things, but very, in my life very important. And I went to Ljubljana...

EK In which year?

AR I graduated in '77, minus four...

EK '73

AR Like that. Ljubljana exhausted me. I meant to never leave Yugoslavia, but Slovenia wasn't Yugoslavia, it was only in name. It was a different world, on one side Italy, on the other Germany {shows two sides with his hands}, very different cultures. But I didn't know. I could see that it was something else entirely, people lived differently around here, differently here, and there in Slovenia differently. I was in a good financial situation, I mention it again. So I had no problems, just to study and that was it. I had a problem with Slovenian, I was, was, was learning it. I learned, I learned nothing, I spoke Slovenian, I spoke and improved.

And I started a routine, not in the Albanian style, I would put up a big piece of paper in my room and I would do 30 of those and on that paper I would draw a square and write what I did that day, what I learned that day, what... as an overachiever you know I wanted to really... and I started learning there, I improved, I began to understand other art as art, I lacked manners, I... our pedagogy was very behind here, here pedagogy was very underdeveloped. And slowly, slowly I'd hear some names, some new things, I heard... mostly it would get on my nerves and this was crucial (laughs), when they would mention Wassily Kandinsky...

EK Why so?

AR Well he was a mix between abstract art and realistic art, and I didn't know those differences, I didn't know yet, I knew and I didn't know. I lacked in Slovenian, I lacked, I didn't lack in books because I read them in Serbian, I couldn't read in Slovenian. I was really famous because I could read Cyrillic, and Slovenians, no one knew (laughs), I was very famous. So I had no problems because they would come to you, students would offer, "I offer help with English! I offer help with French! I offer help with this..." I did the same, I had so many

kurgjo s'më interesojke.

Shkova, qe qekjo ka qenë shumë e randësishme, ajo shumë, shumë, shumë e randësishme. Në atë kohë mu nuk m'u duke kurgjo ajo për mu, eh punë e madhe, çka po... une veç e kisha dertin si m'u pranë në Akademi. U pranova, perfekt. Ma çunë telegrafin. Nji shok, nji djale, se aty ishin studenta shqiptarë, gjakovarë, krejt studentat, pak, s'ishin në Lublanë shumë, njiqind studenta ishin. E njeni, nji Fahri Xharra është, është në Facebook vazhdimisht, nji Fahri Xharra aty, tekstin e studiojke. Ai ma çoi, ma shkroi, i thashë, ma shkroi telegrafin, "Je pranë." U tranova, u tranova, u tranova mandej i kallxova Agim Çavdarbashës, ku—ku—ku çka u gëzu ai shumë, u gëzu shumë që s'i kom kërkun ndihmë. A din pse? Se tha, "Une ta kisha dhonë ndihmën po diqysh kishe vetë keq." A po kupton? Këto ishin sende t'vogla po shumë, për jetën time shumë të randësishme. Edhe shkova në Lublanë është...

EK Në cilin vit?

AR '77 kom diplomu, hekja katër...

EK '73.

AR Ashtu. Edhe ajo m'ka kartiratë [lodhë], ajo Lublana, une kujtojsha mos me dalë prej Jugosllavisë, ajo Sllovenia s'kishte qenë Jugosllavi hiç, ajo kishte qenë veç sa për sy e faqe. Ajo ishte nji botë [tjetër], knej Italia, knej Gjermania, {tregon dy anë me durë} kultura të ndryshme. Po une s'disha, e shihsha që diçka është krejt tjetër, çka o vëlla, këtu tjetërqysh po jetojkan, këtu tjetërqysh, atje në Slloveni tjetërqysh. E unë isha në situatë shumë të mirë materiale, po e cekim prapë. Prandaj unë nuk kisha kurrëfarë problemi, veç me mësu edhe kaq. Kisha problem sllovenishtën ata pa, pa, pa mësojsha. Mësojsha, kurgjo s'mësojsha, folsha sllovenisht, folsha edhe u përmirësojsha.

Edhe fillova me nji rezhim kështu, jo shqiptarçe, e qitsha ka nji hamer në dhomë edhe në hamer i bojsha 30—të edhe

çdo ditë shkrujsha në nji kator çka kom bo sot, çka kom mësu sot, çka... si i smutë pak a din dojsha shumë... Edhe ia nisa me mësu atje, ia nisa me përparu, ia nisa me kuptu artin, tjetër qysh ishte arti, s'i kisha maniret une... pedagogjia jonë është shumë mbrapa, ka qenë këtu, këtu ka qenë pedagogjia jonë shumë mbrapa. Edhe kadalë, kadalë i ndijsha do emna, do sende tjera, i nijsha... ma së shumti nerva m'shkojke kjo ka qenë vendimtare (qeshë), m'shkojke nerva kur ma përmendshin Wassily Kandisky...

EK E pse?

AR Po ai ishte thyerje n'nes artit abstrakt dhe artit realist, une s'i disha ato dallime hala, hala s'i disha, hala i disha e s'i disha. Sllovenishtja më mungojke, më mungojke, librat s'më mungojshin se i lexojsha serbisht, sllovenisht s'mujsha me lexu. Shumë isha i kërkum se une e disha çirilicën me lexu, sllovenët s'dishin kërkush (qeshë), shumë i kërkum isha. Kështu që, s'kisha kurrëfarë problemi se ata plot u ofrojshin, studentat u ofrojshin, "Ndihmoj me Anglishtën! Ndihmoj me Frangjishtën! Ndihmoj kështu..." edhe unë, mu aq shumë m'thirrshin çirilicë që une si kundërshpërblim...

EK E pse ku e kishit ju, ku u përdorë çirilica, n'çka? Në dokumenta?

AR Në libra.

EK Ah, në libra.

AR Në libra valla, libra estetike, libra të artit, ka pasë në Beograd bre gjithçka...

EK Në çirilicë i kanë shkru a?

AR Në çirilicë bre kanë shkru, ata kurrë s'kanë shkru n'latinicë veç çirilicë kanë shkru.

EK Po a?

AR Po (qeshë) aty kur m'pyte edhe njiherë thashë, "A jom mirë une?" në çirilicë kanë shkru.

EK S'e kom... kom mendu që kanë shkru n'latinicë...

AR Jo bre çfarë latinica s'u përdorë hiç, veç në Zagreb u përdorë.

“My brother played the violin, I did not play the violin or any instrument, every time guests came they made Rafet play the violin {explains with his hands}. Rafet does not like talking about this, does not like it at all. I envied him, because I did not know. [...] I used to copy the comics in the window {explains with his hands}. I would copy them in the window, to show off how I drew, I could not draw, I really wanted to know how to draw, I would go crazy, I wanted to be the best in something. Because when guests would come he [Rafet] played the violin and I did nothing, this was my childhood.”

“Vëllau im i ka mshu violinës, unë s’kom ditë as violinës as kurçkafit me i mshu, si janë ardhë mysafirët e kanë shti Rafetin me i mshu violinës {spjeron me duar}. Rafeti s’ka qejf me kallxu hiç këta, hiç s’ka qejf. E mu shumë më ka ardhë inatit, shumë se s’disha. [...] I kopjojsha ato stripat në xham {shpjeron me duar} në xham aty kopjojsha, me tregu qysh di me vizatu, s’disha me vizatu, qef shumë kisha, mentë m’lejshin kisha qef [me qenë] i pari në diçka me randësi. Se kur vishin mysafirët ky [Rafeti] i mshojke violinës une kurgjo, këto kanë qenë ato të fëminisë.”

requests for Cyrillic as an exchange...

AR

And reviews about art abroad. Yes but Yugoslavia was so big, it had many great people, a lot of great people. It is a big sin that you can't look up these things at all. For example sculpture, the greatest man of former Yugoslavia, the greatest in art, the greatest of all time, I think is Ivan Meštrović.²² Ivan the sculptor. The sculptor, I'll just explain this and then I'll come back again. This sculptor was crazy, cheated, he cheated himself with some kind of Yugoslavism, with some sort of slavism and then he made all of Belgrade's memorials, Ivan Meštrović made all Belgrade's memorials, Meštrović sculpted all the horses and all those things at the Assembly. Montenegro's assembly, Njegoš's grave and everything was by Me... Meštrović. Meštrović did work also in Slovenia.

Ivan Meštrović (1883—1962) was born in Vrpolje, Croatia. He was a renowned 20th century Croatian sculptor and architect. Meštrović particularly defined his practice through religious artistic production, mostly made of wood. He was influenced mainly by Byzantine and Gothic architecture. The most renowned works from his early period are Crucifix and Madonna.

EK Why, where did you encounter it, where was Cyrillic used, in what? Documents?

AR In books...

EK Oh books...

AR Yes in books, books on aesthetics, art books, everything in Belgrade...

EK They wrote them in Cyrillic?

AR They wrote in Cyrillic, they never wrote in Latin alphabet only in Cyrillic.

EK Oh, yes?

AR Yes (laughs) when you asked me again I said, "Am I in the right mind?" They wrote in Cyrillic.

EK I did not... I thought they wrote in Latin alphabet...

AR No, they did not use Latin alphabet at all, it was only used in Zagreb.

EK What did you do, did you transliterate it to the Latin alphabet?

AR No, I just translated.

EK Okay.

AR Translated, it had a page, two pages, three pages or something, I translated. Someone had the texts in Serbian and the students there had this good habit, this was very good. I didn't have any problems, everyone translated into English, one page, two pages, biographies. Especially biographies, because biographies you didn't have to know, where Martins is, where this one is, and where this one was, and where he was born and stuff. You know, I understood a bit of Slovenian, partly, I couldn't read Slovenian, my Serbian was perfect and so on... And I read Politika, Subotnja Politika [Saturday's Politics], the newspaper Subotnja Politika, it had critical perspectives on art, they were first-rate. I transcribed this one.

EK

Did he have any sculptures here before, Meštrović?

AR

Where?

EK

In Kosovo so we can relate...

AR

No, we didn't have those here, Kosovo was nothing, thankfully there are some in Belgrade, in Croatia, all of them are there. So he was really big, not even they knew how big he was, how big... what a great artist, you know? I do not know where this came from...

EK About the art in Yugoslavia right...

AR About figurative art in Yugoslavia...

EK Okay.

EK E çka bojshit ju i latinizojshit a...

AR Jo more, veç ia përkthejsa.

EK Okej.

AR Ja përkthejsa, e kishte një faqe, dy faqe, tri faqe diçka ja përkthejsa, dikush kishte literaturën serbisht edhe këta studentë... ishin mirë atje shumë qita, qe qikjo ish shumë mirë. Unë s'kisha kurrëfarë probleme, përkthejke gjithkush anglisht, një faqe, dy faqe, biografi. Sidomos biografi, se biografite s'ki çka u dufshe me ditë, kush është Martinsi, e kush ky, e ku e ky, e ku ka lindë e sende. Sllovenishtën e kuptojshja pak, t'cungume, une s'mujshja me lexu sllovenisht, serbisht perfekt e qeshtu... Edhe lexojshja une "Politika", "Politika e të Shtunës", gazeta "Politika e të Shtunës" ka pasë këndvështrime kritike për artin, kulminante. Këtë e kom diktë.

EK Për artin në Jugosllavi a...

AR Për artin figurativ në Jugosllavi.

EK Ok.

AR Edhe vështrime për jashtë. Po veç Jugosllavia ka qenë shumë e madhe, ka pasë shumë njerëz t'mëdhaj, shumë njerëz t'mëdhaj. Është mëkat i madh që ju s'po mundeni hiç me i kqyrë këto sende. Për shembull skulpturë, njeriu ma i madh i ish—Jugosllavisë, ma i madh n'art, ma i madh prej t'gjitha kohënave, une mendoj është Ivan Meštrović⁷. Skulptori Ivan. Ai skulptori, tash veç po e spjegoj këtë e mandej kthena prapë. Ai skulptori ka qenë i lajthitur, i mashtrumë, e ka mashtru vetën me njëfarë jugosllavizmi, me njëfarë sllavizmi edhe mandej ai krejt Beogradit ia ka bo përmendoret, krejt përmendoret e Beogradit i ka bo Ivan Meštrovići, krejt kuvendit, krejt ata kuajt e ato sende i ka bo Ivan Meštrović. Malit të Zi, kuvendin e krejt, vorrin e Njegoshit e krejt e ka bo Me... Meštrovići. Në Slloveni ka bo Meštrovići.

Ka qenë shumë i madh, mandej u ikë, gjatë kohës së kësaj, ka ikë në Amerikë. Edhe në Amerikë, midis Chicagos i ka... skulpturat e Meštrovićit jonë, i ka fitu në konkurs

gjithëbotëror me indianët t'u gjujtë, edhe ajo shumë, shumë skulpturë e madhe, kali kësh-tu {tregon me duar}... Dome-thonë këtë po e tregoj se sa i madh është a di, Amerika nuk t'njeh kush je ti, a je kroat a çka je a... Ky ka qenë kroat Meštrovići, po është habitë me këtë jugosllavizmin, ka qenë i lajthitur... Edhe ato duhet me lexu, ato duhet me mësu bre, atë artist duhet me mësu bre. Njerëz të kategorisë t'lartë, pa marrë parasysh çka jonë, ata duhet me i ditë, duhet me i ditë kush jonë, duhet me ditë kush është Nikola Tesla bre. Ai në Amerikë është hero. Është emër shumë i madh.

EK E a ka pasë skulptura ai edhe këtu përpara, Meštrovići?

AR Ku?

EK Në Kosovë po thom, ta di që na me pasë kontakt...

AR Jo, s'kena pasë na kështu, Kosova ka qenë kurkushi edhe shyqyr në Beograd ka, në Kroaci, krejt jonë. Domethonë, shumë i madh ai, as këta s'e kanë ditë sa i madh është, sa i madh... sa artist i madh, a din? S'di përtej çkafit e mora këtë, këtë...

EK Për vështrimet që i keni lexu në "Politika" në atë kohë?

AR Edhe po, eh, eh, eh... edhe une "Politikën e të Shtunës", une u çojshja midis Lublanës, a s'i dojshja, Beogradin s'e dojshja aty, "Politika" merre me mend, gazetë e politikës, kishte vështrime marramendëse. Nji ditë po lexoj, nji ditë po lexoj qysh në Minhen po hapet ekspozita e Wassily Kandisky, "Retro-spektiva". Ai m'u pat' bo pikë ajo, ato s'disha kurgjo hiç, folshin këta s'i kuptojshja çka po thojnë, hiç s'i kuptojshja çka po thojnë. Artin abstrakt unë s'e disha çka është, këta në Shkollë të Lartë s'na kishin mësu kërkush, këta abstrakt punojshin, po abstrakt nat-uralizëm, a din qashtu gjysë abstrakt, njëfarë gjysë... po ti mos ma përzi bre thuje kllot bre ja kështu, se nuk di une, ndama, ndama, çelmi sytë. Shujta, m'vike inati, sllovenët krejt botën e dishin, studentat sllovenë, kolegët, dishin vëlla, ata kishin pa, une s'ki-sha pa. S'disha une, as s'disha

7

Ivan Meštrović (1883—1962) u lind në Vrpolje, Kroaci. Ka qenë skulptor dhe arkitekt i njohur kroat i shekullit XX. Meštrovići, praktikën e tij krijuese e ka definuar drejt prodhimit religjioz artistik, të cilat i ka punuar kryesisht në dru. Në punën e tij janë ndier ndikimet nga arkitek-tura Bizantine dhe Gotike. Punët e tij më të njohura janë nga periudha e hershme krijuese si Crucifix dhe Madonna.

EK We were talking about the reviews that you read in Politika at the time.

AR And yes, hmm, hmm, hmm... and Subotnja Politika [The Saturday's Politics], I woke up in the middle of Ljubljana, I didn't want to, I didn't want Belgrade [to occupy my mind] there, imagine Politika, a newspaper on politics that had great art reviews. One day I was reading, one day I was reading how in Munich a retrospective exhibition of Wassily Kandinsky was about to open. I was obsessed by it, I didn't know anything at all, they kept talking and I didn't understand what they were saying, I didn't understand at all what they were saying. I didn't know what abstract art was, in Shkolla e Lartë no one taught us that, they did abstract art, but abstract naturalism, you know, half abstract somehow half... do not mess around, say it directly not this way because I don't know, break it down for me, open my eyes. I didn't say a word, I was frustrated, Slovenians knew all the world, Slovenian students, colleagues, they knew, they had seen, I hadn't seen. I didn't know, I didn't know what the Louvre was, I didn't know, I didn't know anything, it was then that I saw, I thought that I knew. I didn't know anything.

I woke up one night, Thursday evening and I took, I bought one rucksack {explains with hands} to go like, like... that time they went... it was like hippie, you know like this with a sack and everything, everything, everything... without speaking German or English, nothing at all, I left, I went to Munich. I went to Munich, I took this [sleeping bag] so I could sleep somewhere in the park, I knew that if there is a museum then there is a park, in Austria... and... I mean Munich... and I had to learn the routine of these trips, how would I know? You know, without speaking the language, without knowing anyone... then many years, many years, ten years I went like this, I traveled without knowing anything. I learned the system without speaking the language, you

know? You don't know the struggle when you travel and you don't speak the language.

And I wanted to sleep in the park but the police wouldn't let me, you had to sleep at night and you had to go into museums during the day, we left our things in those [boxes] at the station, somehow you left them {explains with hands}, you learned these things without speaking the language, it was hard to learn them (laughs)... I entered the Kandinsky museum, my God so many floors Kandinsky. I wanted to go crazy with how much I didn't know, but I read a lot, I read a lot about Kandinsky, who he is and what he is but I didn't understand. You know... the beginnings of abstract art and everything... there, there I, there while reading, because I wanted to be the best student, I didn't want to be mediocre I wanted to be the best, the best out of the Slovenians, they were all Slovenians.

I looked at the blue period, the green period this way, I started mechanically to learn what they were... I went, I couldn't stay from the morning, I couldn't stay from 9AM to, to 5PM in the afternoon. I paid two tickets, first I went out and slept in the grass for an hour because like that, and then the second ticket, nonsense but this way... I came, I went, I stayed for two days, two days in the museums that for me were like, like discovering America. I saw Kandinsky, they drove me mad with this Kandinsky, I didn't understand it. I followed that, I didn't tell anyone that I was in Munich, at all, at all, at all...

Read, read at night like crazy, read that one... about his life and about his views, I still didn't know, I still didn't know them aesthetically, but I understood them before the time. I started, I couldn't help myself when they talked, I said, "But no, this is the blue period, it has... it's a short period..." Kandinsky was crazy with music, he wanted to make paintings by obeying the principles of music. But you can't with the

çka është Louvre, as s'disha, s'disha kurgjo tek qatëherë e pashë, kujtojsha që po di.

Kurgjo s'disha. E t'jom çu një natë, t'ejtën prima te kom marrë atë, e kom ble asi rucksack⁸ {shpjegon me duar} për me shku si, si... atëherë shkojshin... ka qenë si hipik, a din kishe me thes e me krejt, krejt, krejt... pa ditë as gjermanisht, as anglisht, as kurgjo, jom nisë, jom shku në Minhen. Shkova në Minhen, këto e mora për me flejtë dikun te parku, e disa unë si t'është muze ka park, në Austri... edhe... në Minhen po mendoj... Edhe u duhsha m'i mësu shtosat e këtyne udhëtimeve, ku ki me i ditë ti bre? A din pa ditë gjuhë, pa ditë kërkush... mandej shumë vjet, shumë vjet, dhjetëra vjet kom shku kështu, pa ditë kurgjo kom udhëtu. E mësova sistemin pa ditë gjuhë, a din? Nuk e dini këtë dert sa keq është kur shkon e s'din gjuhë.

Edhe dojsha me flejtë në park po s'lejshin milicët, u dufshe natën me flejtë e u dufshe ditën me shku për në muze... i lejshim n'stacion ishin ato, njëfarë asi i lejshe ato {tregon me duar}, ti i mësojshe këto sende pa ditë gjuhën, zor ishte m'i mësu (qeshë)... Hyna në muze, Kandinsky, o Zot në shumë kate Kandinsky. Dojsha m'u tranu qysh s'po i di, po unë pata lexu shumë, une pata lexu shumë për Kandinskyn, kush është, e çka është, por s'e kuptojsha. A din... fillet e abstrakcionit e krejt... aty, aty une, aty t'u lexu, aty se dojsha m'u bo ma i miri prej studentëve, s'dojsha une gjysë më konë, ma i miri dojsha, ma i miri prej sllovenëve, krejt sllovenë i kisha.

E kqyra, periudha e kaltërt, periudha e gjelbërt, periudha kështu, ia nisa mekanikisht m'i mësu cilat jonë e qysh... Shkojsha, s'mujsha me nejtë prej mengjesit, s'mujsha prej 9:00 deri, deri në 5:00 masdite me nejtë. Pagujsha dy bileta, një dilsha flejsha një sahat qaty n'bari se qashtu, e mandej të dytën biletë, sende palidhje po qishtu... Erdha, shkova, dy ditë nejta, dy ditë n'muze për mu ish ajo si mi, si mi gjetë Amerikën. E pashë Kandin-

skyn, ma patën lodhë shpirtin me atë Kandiskyn kuku se kuptojsha. T'i hina tash mas asaj, shuj, kërkujt s'i kallxova që jom konë në Minhen, hiç, hiç, hiç...

Lexo, lexo natën si i trent, lexo atë... për jetën e tij e për ato vështrimet e tij, hala s'i disha, hala me estetikë s'kisha shku une për me i kuptu ato, por i kuptova para vaktit. Ia nisa s'mujsha me duru tash kur folshin ato, thojsha, "Jo bre, kjo është periudha e kaltërt, i ka... periudhë është e vogël..." Ku ka qenë ky i lajthitur Kandinsky me muzikën, ka dashtë me bo pikturë si me ligje t'muzikës. Po nuk bon me ligje të muzikës, e ka pa vetë n'fund që nuk bon, po veç folsha me serbez (qeshë) para studentëve, "Çka u bo me këtë Agimin, ai Zot, o Zot?" U ndërrova une, ia nisa m'u ndërru. Eh mandej ajo s'kishte të ndalun, mandej ajo s'kishte të ndalun. Mandej në mramje une nuk shkojsha n'shpi, në 7:00 sahati isha në bibliotekë, në bibliotekë të Akademisë, ka pasë Akademia shtatë... prej të hanës deri t'premtën.

- Dikush mirrej me ndonji instrument, dikush shkruante poezi, dikush këndonte, kurse grupi i, disa shokë me mua, ne mirreshim me artin figurativ. Pra, na kishin dhanë ngjyra, na kishin dhanë letra, pastele të ndryshme dhe kështu. Më pas kthimit veror nga bregdeti Dalmatin i Kroacisë, unë kisha bërë, në vitin e dytë të Shkollës së Artit, kisha bërë një peisazh, mund të them të bukur meqë mësuesja ime e pëlqeu shumë. E mori ua tregoi kolegëve të mi, mua më morri për dore dhe më çoi në klasët e tjera për t'iu treguar nxënësve të tjerë, të klasëve të tjera. Edhe, "Ja ky shoku juaj, se sa bukur ka vizatuar, ka pikturuar në të vërtetë një peisazh..." ku ishte një anije në bregdet me vela t'bardha me disa palme këtu në plan të parë. Dhe ajo ishte shtytja, mendoj, shtytja ime e parë dhe mendoj që mësuesja ime, e cila ishte motra e Bekim Fehmiut, motra ma e vjetër, ishte një mësuese shumë e mirë dhe ajo, unë mendoj, kishte zbuluar për herë të parë që unë kisha talent për artin figurativ.
- Pastaj, pastaj ishte me randësi që unë vajta në Shkollën e Mesme të Arteve. Atje kishim profesorë të cilët ishin, për atë kohë ishte shumë me rëndë

us about Albanian figurative art, but only about Yugoslav figurative art, but...

EK What was at that time, since I mean it was early to understand what Yugoslavia was? How many years were there... 16, 17, how many years were under Yugoslavia?

SHN I mean, at that time I was 15—16—17 years old and I couldn't understand it. As every child at that age doesn't understand what politics are, what is the state, what is the occupation and whether it is camouflaged or not, because they spoke about how we were all equal. Brotherhood and Unity⁴ was the banner which of course was demagogic. But, what was important was usually that I had to deal.... I mean, this age is important to learn what one has to learn and I was able to express my talent... I have some classmates who later told me, they said, "Each time we asked you for something, you would only draw and do nothing else." I mean I was pre-occupied with art even in other classes when there were other subjects, I wanted to draw and it was something that really spoke about my lifetime pre-occupation, which is visual art.

EK What style, what art movements were promoted in Yugoslavia at that time, I mean what was the main influence at Shkolla e Mesme e Artit in Peja?

SHN Yes, to be honest, Yugoslavia compared to other states of the Eastern Bloc which were under the influence of Soviet Union, which today is called the Russian Federation, back then soc—realism happened in all the countries, especially in our mother country, Albania. In Yugoslavia they were abandoned in... around the middle of the '50s. Because a very famous painter from Croatia, Edo Murtić,⁵ returned from the United States of America after having been there on a Fulbright scholarship and had worked at the same studio as Jackson Pollock. Now, imagine, with Jackson Pollock! And I remember Edo Murtić told me that, the latter—mentioned is deceased now, that if he only

had a small painting, no matter how small, of Jackson Pollock, he would be a millionaire today. With the return of Edo Murtić, who was a par excellence painter, an amazing expressive painter, I opened an exhibition of his when I was a director of the Arts Gallery of Kosovo.⁶ I opened his solo show here in Pristina. Edo Murtić was also a very good friend of Albanians because we created contact with the galleries of Yugoslavia, especially with the one in Zagreb that was called Galeria Forum and was led by Vlado Bužančić, the best art historian and critic in Yugoslavia.

So when he returned to Yugoslavia, that is when socialist art was abandoned in Yugoslavia and free art began then we, the artists of Kosovo, had the very great luck of not being isolated. The doctrine of soc—realist art was not imposed on us compared to our brothers, colleagues, the Albanians in Albania, who suffered for a long time. Even though a part of them created works that had... I mean extraordinary quality, they are good... I mean, Sali Shujaku is a painter who at that time was very expressionist. And when we visited Albania for the first time in '72, we would say good words about how beautiful and expressionist it was, he would say, "Please don't say good words about me because you will be my curse." Because at that time of course they would drag him to a place in Albania where he would not be able to be free, such was the situation there.

So, figurative art in Kosovo was fortunately free at that time, it was free and all the artists, starting from the first generations of Agush Beqiri,⁷ Nuredin Loxha,⁸ Engjëll Berisha,⁹ Nysret Salihamixhiqi,¹⁰ Muslim Mulliqi¹¹ and some others were totally free. Each one of them painted in their own way, each one of them... the names I mentioned are really specific, some of them were more into expressive art, some into the surrealist style, some with our Byzantine tradition translated

4 Brotherhood and Unity was a popular slogan of the Communist Party of Yugoslavia that was coined during the Yugoslav People's Liberation War (1941—45), and which evolved into a guiding principle of Yugoslavia's post-war inter-ethnic policy.

5 Edo Murtić (1921—2005) was a painter from Croatia who was best known for his lyrical abstraction and abstract expressionist style. He worked in a variety of media, including oil painting, gouache, graphic design, etc. He was renowned in Yugoslavia for breaking away from the socialist realist art style.

6 The Pristina Gallery of Arts was the first exhibition space in the then—Yugoslav province of Kosovo. The gallery space was established in 1979 and located in the Youth and Sports Center—Boro dhe Ramizi.

7 Agush Beqiri (1932—2006) was born in Peja, Kosovo. He was a Kosovo Albanian interior designer and architect.

8 Nuredin Loxha (1935—1992) was a Kosovo Albanian librettist, set designer, production designer and costume designer.

9 Engjëll Berisha (1926—2010), also known as Befre, was an Albanian painter from Kosovo. He graduated from the University of Belgrade in 1954. He was a member of the Academy of Figurative Arts of Kosovo.

10 Nysret Salihamixhiqi (1931—2011) was born in Zhabar, near Mitrovica. He was a Kosovo Albanian abstract painter. He studied applied arts at the University of Belgrade in 1959 under the mentorship of Vasa Pomorisac.

11 Muslim Mulliqi (1934—1998) was an impressionist and expressionist painter from Kosovo. Born into a family of artists, Mulliqi attended the Academy of Fine Arts in Belgrade under Zoran Petrović's mentorship, where he also continued with his postgraduate studies.

- si, që e kishin kry Fakultetin e Arteve. Ishin të gjithë të kualifikuar. Pra, ishte një staf shumë i mirë dhe aty na filluam të njifemi me artet figurative edhe pse asnjëherë profesori i historisë së artit nuk na filste për artin figurativ shqiptar por vetëm fliste për artin figurativ jugosllav, mirëpo...
- EK Çfare ishte në atë kohë, meqenëse ishte ende herët, po mendoj me kuptu çka është Jugosllavia? Ishin vitet... 16, 17 sa i bjen që ishin nën Jugosllavi?
- SHN Po unë mendoj që në atë kohë, në moshën time do të thotë diku 15—16—17 vjeçare, unë nuk mund të kuptoja. Si çdo fëmijë në atë moshë, nuk kupton çështje politika, çështje shteti, çështje okupimi i cili është i kamufluar apo jo? Se aty flitej që kemi barazi të gjithë. Vllaznim Bashkim¹ ka qenë parolla e cila ishte demagogjike natyrisht. Por, ajo që është deshtë dhe që është e zakonshme unë është deshtë të mirrem. Pra mosha, kjo moshë është me rëndësi të mirret të mësosh atë çfarë duhet mësuar dhe unë isha në gjendje ta shprehi pra talentin tim.... Dhe i kam disa shoqe të cilat ma vonë më kanë treguar që kanë qenë me mu në klasë. Thonë, "Sa herë që kërkonim diçka nga ti, ti vetëm vizatoje kurgjo tjetër". Domethënë unë kam qenë i preokupum edhe në orët, domethënë edhe në orët e mësimit edhe ku kanë qenë lëndët tjera unë vetëm kam pasë dëshirë të vizatoj dhe kjo ka qenë diçka që ka treguar vërtetë preokupimin tim jetësor që sot të jetë arti pamor.
- EK Çfarë stili, apo çfarë lëvizje në art u promovojshin prej Jugosllavisë në atë kohë, po mendoj çka ka qenë brumi që ju e merrshit në Shkollën e Mesme në Pejë?
- SHN Po, në Jugosllavi çështje e vërteta në krahasim me këto shtetet tjera të kampit lindor të cilat ishin nën ndikimin e Bashkimit Sovjetik, që sot quhet Federata Ruse, atëherë soc—realizmi që ka ndodhë në të gjitha këto shtete dhe sidomos në shtetin tonë amë, në Shqipëri, në Jugosllavi u braktisën në vitet... në, në mesi

i viteve të '50—ta. Për arsye se një piktor nga Kroacia shumë i njohur, Edo Murtić², ai ishte kthyer nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i cili kishte qenë me bursën e Fullbright dhe kishte qenë me një studio me Jackson Pollock. Tash merre me mend me Jackson Pollock... Dhe m'kujtohet edhe Edo Murtić më pat' treguar, vetë ky piktor tashmë i ndjerë, se ai po ta kishte vetëm një pikturë t'vogël, sado të vogël të Jackson Pollock sot do të ishte bërë milioner. Pra kur me, me kthimin e këtij Edo Murtićit, i cili ishte një piktor par excellence, një piktor ekspresiv i shkëlqyer edhe unë ia kam pasë hapë një ekspozitë kur isha drejtor i Galerisë së Arteve të Kosovës, e pata hapë ekspozitën personale këtu te ne në Prishtinë. Edo Murtić ka qenë edhe mik shumë i mirë i shqiptarëve se patëm bërë një kontakt me galeritë e Jugosllavisë sidomos me atë të Zagrebit, e cila ka qenë Galeria Forum të cilën e udhëhiqte Vlado Bužančić i cili ka qenë historiani më i miri i artit dhe kritiku në ish—Jugosllavi.

Kështu që kur u kthy ai në Jugosllavi, atëherë në Jugosllavi u braktis arti socialist dhe filloi arti i lirë dhe prandaj ne artistët e Kosovës kemi pasë një fat shumë të madh që nuk kemi qenë të kufizuar. Na nuk e kemi pasë të imponuar doktrinën e soc—realizmit në krahasim me vëllezërit tanë, kolegët tanë, shqiptarët në Shqipëri, të cilët me të vërtetë kanë vujtë për një kohë shumë të gjatë. Edhe pse një numër i tyre kanë kriju edhe vepra të cilat kanë... domethënë cilësi të jashtëzakonshme, janë të mira... për shembull Sali Shijaku është një piktor i cili që në atë kohë ka qenë shumë ekspresionist. Dhe kur e patëm vizitu ne Shqipërinë për herë të parë atje, '72—shën, ne e lavdonim një pikturë të tij se sa ishte e bukur, ekspresioniste edhe ai thoshte, "Oh ju lutem mos më lavdoni se do t'iu shoh sherrin". Se në atë kohë normal do t'ia syrgjynosnin dikah në ndonji hapësirë të Shqipërisë se ku ka... ku nuk kanë mund të, të jenë të lirë apo jo, deri aty ka qenë çështja.

1
Vllaznim Bashkim është një slogani i popullarizuar i Partisë Komuniste të Jugosllavisë, i cili u sajua gjatë Luftës Nacional—Çlirimtare të Popujve Jugosllav (1941—45), dhe i cili evoluoi në një politikë ndër—etnike dhe në një princip udhëzues për Jugosllavinë e pas luftës.

2
Edo Murtić (1921—2005) ishte piktor nga Kroacia, i cili ishte i njohur për stilin e tij abstrakt e lirik dhe ekspresionizmin abstrakt. Ai ka punuar në media të ndryshme, përfshi pikturën në vaj, gouache, dizajnin grafik etj. Ishte i famshëm në Jugosllavi për shkëputjen e tij nga stili artistik soc—realist.

into contemporary art.

And it is a very good luck that in Kosovo however, a tradition was created, compared to my generation that didn't have [a tradition to refer to]. The new generations can be proud because they have a tradition and have those painters whom they can refer to and be proud of because they all attended... I mean all the artists that I mentioned were part of biennial and triennial exhibitions, be it in the region of former Yugoslavia or in Europe as well as in other continents.

Speaker: Shyqri Nimani

EK What happened to you then, you finished Shkolla e Mesme e Artit and went to Belgrade?

SHN Yes...

EK Can you tell us more about the time during your studies...

SHN Yes...

EK Or your artistic growth?

SHN After five years I finished the Shkolla e Mesme e Artit in Peja, which let me mention again was a very good school, its staff was very good and I finished it with good success. And I thought that as far as figurative art went, I had learned. But, this was as a... as a, practically a trap of a youngster who no matter what, hadn't seen the world yet, right? Because Kosovo was pretty stuck. Our cities, we still didn't have the university, which is an extraordinarily important thing, we had no exhibitions. We had no gallery and with the lessons I took at the Shkolla e Mesme e Artit and the high grades I had received, I thought that the whole world was mine and when I continued to Belgrade I wanted to...

Interviewer: Erëmirë Krasniqi

EK Can you tell us about the absence of art in public because it seems very interesting. How... since there were no exhibitions, you actually had no access to art, there were... the everyday was not aestheticized as much, so could you tell us how, how did you decide to engage in something like art while at the same time it was not part of the public sphere?

SHN Very, very beautiful, very existential question. It is true that

Interview

such was Kosovo, it was stuck, I mean communism came right after the Second World War. Because Yugoslavia used to be a monarchy before and Albanians had no rights. And with communism somehow, with their slogan that communism was building a society under the Brotherhood and Unity syntagm, which as I told you before, was demagogic.

It could have importance for the Slavs that lived in former Yugoslavia, but to us, nothing was better than starting to obtain some elementary rights, to have elementary and high schools. Even though in the Shkolla e Mesme e Artit in Peja we only had the Albanian language and literature course in Albanian, all the other courses were in Serbo—Croatian, and this speaks to the national injustice we suffered. And so it all depended on the talent which we expressed.

For example I remember I went to Gjakova from Peja and I met Muslim Mulliqi there. Muslim was, he was a little older when he started, he was seven years older than me but Muslim was preparing an exhibition of figurative arts with his own paintings, and he invited me to his house to comment on them, I mean this was all we had. Maybe the first exhibition of Muslim and any other painter, in spaces... I don't even know what spaces those were, because we had no gallery. Exhibitions were organized in school spaces.

So, these were the first extraordinary attempts that not only we, the young generations who were talented in figurative art, but also in literature, because literature had started at that time. Poetry was especially developed, there was the poet Ali Podrimja,¹² he was my friend and we would meet, there were the older generations like Esad Mekuli,¹³ who was a poet and translator, and later he led the first magazine in Albanian, *Jeta e Re* [New Life], which was practically a garden where not only poets and writers gathered. But, Esad Mekuli was a visionary

12

Ali Podrimja (1942—2012) was born in Gjakova, Kosovo. He was the most well-known Kosovo Albanian poet.

13

Esad Mekuli (1916—1992) was born in Plava, Montenegro. He was an Albanian poet and scholar. He was the first president of the Academy of Sciences and Arts of Kosovo. He died in Pristina, Kosovo.

Kështu që për fat të mirë arti figurativ domethanë edhe në Kosovë në atë kohë ka qenë i lirë, i liru dhe të gjithë artistët, duke filluar nga këto gjenratat e para ku ka qenë Agush Beqiri, Nuredin Loxha, Engjëll Berisha, Nysret Salihaxhiq, Muslim Mulliqi e disa të tjerë kanë qenë krejtësisht të lirë. Kanë pikturuar secili në mënyrën e vet, secili ka... këta emra që i përmenda janë me të vërtetë shumë karakteristik, dikush është me një art ekspresiv, dikush me pak a shumë surrealist, dikush tjetër është me me traditën tanë bizantine të transliteruar në art bashkëkohor.

Dhe ky është një fat shumë i mirë që na në Kosovë megjithatë deri kur erdh gjenerata ime kemi kriju një traditë në krahasim me ne që më parë nuk kemi pasë. Sot gjeneratat e reja mund të mburren se kanë, e kanë megjithatë, një traditë dhe i kanë ata piktorë më të cilët mund të thirren se, edhe të mburren më njëfarë mënyre, për arsyse se të gjithë kanë marrë pjesë. Këta artistat që i përmenda kanë marrë pjesë nëpër ekspozita bienale, triennale, qoftë në hapësirat e ish—Jugosllavisë por edhe në hapësirat Europiane edhe, edhe të kontinenteve të tjera.

EK Çka ndodhi me juve mandej, ju e përfundutë Shkollën e Mesme dhe shkutë në Beograd?

SHN Po.

EK A mundeni me na tregu ma shumë për kohën e juaj gjatë studimeve...

SHN Po.

EK Apo rreth përpunimit tuaj artistik?

SHN Mandej unë pas pesë vjetësh kryva Shkollën e Arteve Aplikative të Pejës e cila edhe një here e ceku ka qenë shumë e mirë, stafin e ka pasë shumë t'mirë dhe e kreu unë me një sukses të shkëlqyshëm. Dhe unë mendoja që sa i përket artit figurativ unë kisha mësuar. Mirëpo kjo ishte, kjo ishte një... praktikisht, një grackë e një të riu i cili megjithatë nuk e kishte parë ende botën apo jo? Sepse Kosova ishte bukur

e prapambetur. Qytetet tona ende, na nuk kishim ende universitet që është një gjë jashtëzakonisht e randësishme dhe nuk kishim ekspozita. Nuk kishim galeri dhe me mësimin që kisha bërë unë në Shkollën e Artit dhe i kisha marrë notat e shkëlqyera unë mendoja se tash krejt bota është e ime dhe kur vazhdova në Beograd unë doja të...

EK A kishit mujtë ma shumë me na tregu për, për këtë farë mungesën e artit në publik se shumë po duket interesant. Si... që s'ka pasë ekspozita që në fakt ju, ju nuk keni pasë qasje në art, nuk kanë qenë... përditshmëria nuk ka qenë shumë e estetizime, kështu që a kishit mujtë me na tregu qysh, qysh ke vendosë me bo diçka që ka të bëjë me art e në të njejtën kohë nuk keni pasë publik?

SHN Shumë, shumë bukur, shumë, shumë qenësore kjo pyetje. Është e vërtetë që e tillë ishte Kosova, ishte shumë e prapambetur, domethanë tek mas Luftës së Dytë Botërore erdh komunizmi. Se përpara Jugosllavia ka qenë mbretëri dhe shqiptarët nuk i kanë pasë kurrfarë të drejtash. Dhe me komunizëm me njëfarë mënyre me parollën e tyre që komunizmi po e ndërton një shoqni e cila e kishte sintagmën, Vllaznim Bashkim që thashë ishte një demagogji.

Por ndoshta për sllavët që ishin në hapësirën e ish—Jugosllavisë mund të kishte ndonjë, ndonjë rëndësi, por për ne shqiptarët ne nuk kishim diçka ma mirë sesa që kishim filluar të fitonim disa të drejta fillestare, t'i kishim shkollat fillore, shkollat e mesme. Edhe pse në Shkollën e Mesme të Artit në Pejë na vetëm gjuhën shqipe si lëndë e kemi pasë në shqip, të gjitha lëndët tjera kanë qenë në serbo—kroatisht, dhe kjo tregon se sa kemi qenë na, domethanë të, të padrejtat tona domethanë kombëtare dhe elementare. Dhe kështu që krejt është mvarë prej talentit të cilin e kemi shprehë na vet.

Për shembull, mu më kujtohet, vajta une prej Pejës në Gjakovë dhe atje u takova me

that in every new issue of *Jeta e Re*, which was issued once a month, he published a number of drawings or paintings of a young artist that was coming to Kosovo.

So, I can say that commitment is number one and space can be found even in inappropriate circumstances once there is an innate will, not an imposed one. That is why, in a way we had nowhere to refer to, we had no art history books which is very important... they only existed in Slavic languages or other languages. But besides Albanian, in the *Shkolla e Artit* we had to also learn Serbian, French and German, and I had already started to learn English myself while still in the *Shkolla e Artit*, because I liked the songs of the famous singers back then and I wanted to understand what those songs were about.

And so I started learning English myself and this helped us that maybe... to use the chance especially when we went to Belgrade to study. There were libraries, there was the American Informative and Cultural Center, which had an extraordinary library, they had art history books just like the libraries in Belgrade did, and of course our horizons expanded while in Belgrade. Since there were many galleries and 20 to 25 exhibitions would open in a single night, it was difficult for us to decide which one we wanted to go to, but we also had the chance to go and visit them later.

So it was very difficult, we had no spaces, but figurative art was done spontaneously from us, from the first generations of Kosovo who were engaged in figurative art, and this speaks about how we were not inspired by anything else but our spirit. I mean, it exploded and we had opportunities, the environments were really beautiful, the environment of Peja for example, Rugova Canyon, the beautiful Albanian *kulla*¹⁴ and all those. The Rugova Canyon and all the others inspired us to draw, paint and of course some of us still save a number

of those works.

I saved them and some of my colleagues have done the same, because no matter what, your first works are important because what have you done if when years pass you have everything but don't have a single work of your own. While still at the *Shkolla e Mesme e Artit*, in the fifth year I worked on an *intarsia*; *intarsia* is a technique in which one works with wood—based panels, I worked on a landscape, a boat, see it is related to boats again because I loved the sea. It was a ship in the storm and the school director gave it to an army official as a gift for visiting our school. And today, I would give everything just to see how I did it so that the director of the school estimated it to the level that he could give it as a gift to an important army official who came as a guest.

That is why I am saying that art is something deriving from the soul of the human, not everyone can do art. Figurative art, theatre, literature are things that only belong to those who have been gifted by God, or by the family pedigree. If somebody from one's family was engaged in arts before, that is going to affect the child as well. But, neither my mother nor my father were engaged in arts; that is why I don't even know where my talent for figurative art came from. I saw my paternal uncle who lived there, he was a director of an institution, and when he met me he said, "Where are you going?" I said, "I am going to enroll..." He met me by accident on the boulevard of Belgrade right at the moment I was going to enroll in the Music Academy. And he said, "No," he said, "you have finished the school of art and you should continue at the Academy of Arts." And he was right, I cannot imagine what kind of life I would have had if I went to the Music Academy.

And I enrolled, it was very difficult because the acceptance exam lasted very long, it lasted for five days and the compe-

Muslim Mulliqin. Edhe Muslimi ishte, kishte filluar ma i vjetër, ishte nja shtatë vjet ma i vjetër se unë, por Muslimi po përgadiste një ekspozitë të artit figurativ me piktura të tij dhe më ftoi domethanë në shtëpinë e tij t'i komentojmë ato, domethanë kjo ishte krejt çka kishim na. Ndoshta ekspozita e parë e Muslimit edhe ndonji piktori tjetër, në hapësira, edhe as vet nuk e di se çfarë hapësira kanë qenë se s'kemi pasë galeri apo jo? Ose nëpër disa hapësira të shkollave janë hapë.

Pra kjo, këto kanë qenë tentativat e para të jashtëzakonshme që jo vetëm ne, gjeneratat e reja të cilët ishim të talentuar në artet figurative, në letërsi se pat' filluar në atë kohë edhe letërsia. Sidomos poezia ishte, u zhvillua me të madhe, ishte poeti Ali Podrimja, unë e kisha shok atë dhe takoheshim edhe ishin gjeneratat ma t'vjetra si Esad Mekuli. I cili ishte poet dhe ishte përkthyes, dhe më vonë ai udhëhiqte revistën e parë në gjuhën shqipe "Jeta e Re", e cila ishte praktikisht, ishte një kopsht ku jo vetëm poetët, shkrimtarët, por Esad Mekuli ishte një njeri aq largpamës saqë në çdo numër të "Jetës së Re", e cila dilte një herë në muaj i botonte edhe, edhe një, një numër të vizatimeve apo të pikturave të një artisti të ri që po vinte në Kosovë.

Kështu pra me një vullnet mund të them spontan, jo të imponuar, dhe në rrethana jo të përshtatshme gjithmonë gjindet domethanë gjindet hapësira, krijohet vullneti, devotshmëria është numër një. Prandaj në këtë mënyrë ne nuk kishim me të vërtetë ku të shifnim, nuk kishim libra të historisë të artit që është gjë, gjë shumë e rëndësishme. Ato ekzistonin vetëm në gjuhët sllave apo ndonji gjuhë tjetër, për shembull. Mirëpo, ne duhet të mësonim se në Shkollën e Artit mësonim pos shqipes, serbishten, frengjishten edhe gjermanishten e unë kisha filluar vet ta mësoja edhe anglishten që në Shkollën e Artit. Sepse më pëlqenin këngët e këngëtarëve të njohur atëherë dhe kisha dëshirë që ato këngë

t'i kuptoj se për çka flasin ato.

Edhe atëherë unë fillova vet ta mësoj anglishten dhe kjo na ka ndihmu që ndoshta kur ke... që të shfrytëzohet rastin sidomos kur kemi shkuar të studiojmë në Beograd. Kanë ekzistuar edhe bibliotekat, ka qenë Qendra Informativ Kulturore Amerikane, e cila ka pasë bibliotekë të jashtëzakonshme, ka pasë libra të historisë së artit sikur që edhe ka pasë, kanë pasë edhe bibliotekat e Beogradit dhe natyrisht në Beograd mandej na u hapën horizontet. Meqë atje kishe shumë galeri për një mramje mund të hapeshin 20 deri 25 ekspozita ashtu që ishte vështirë për ne të caktonim se në cilën do të shkojmë, por kishim rastin që t'i vizitonim ma vonë.

Pra ka qenë shumë e vështirë, mirëpo në hapësirat pra kosovare për ne gjeneratat e para të Kosovës që jemi marrë me art figurativ meqë arti figurativ te na është ba spontanisht dhe kjo ka tregu domethanë që nuk na ka inspiru diçka tjetër por vetvetiu domethanë ajo që është në shpirtin e njeriut. Domethanë ka shpërthyer dhe na atëherë kemi pasë mundësi ambientet kanë qenë shumë të bukura, ambienti i Pejës për shembull, Gryka e Rugovës, ato kullat e bukura shqiptare edhe të gjitha ato. Kanioni i Rugovës e të gjitha ato na kanë shtyrë që të vizitojmë, të pikturojmë dhe natyrisht një numër nga ato punime i ruajnë dikush prej nesh.

Unë i kam rujtë disa edhe kolegët tjerë i kanë rujtë se megjithatë punimet e para kanë randësi shumë të madhe se kur kalojnë vitet ju do të jepnit shumë dhe çdo gjë që ta kishit një punim nëse nuk e keni, se çfarë keni bërë atëherë. Dhe unë e kom pasë punu në Shkollën e Artit diku në vitin e pestë një intarzion, intarzion është një teknikë me furnir punohet, një, një peisazh, një anije përsëri po lidhet anije se mu gjithmonë m'ka pëlqy deti. Ka qenë një anije në furtunë, në shtrëngatë edhe atë drejtori i shkollës ia kishe dhanë një ushtaraku. Edhe unë sot, për dhuratë që e kishte vizitu

“Akademia ishte shumë e fortë, me profesora domethanë në Pragë, në Minhen, në Paris dhe kishin vjelë në ato qytete dhe që kishin mësu në Beograd, Zagreb, Lublanë. Dhe shihej ndi të Kosovës që kanë studiu, këta duhet ta cel blanë kanë marrë ndikimin e atyne profesora dimet e tyre në, që i thashë këto qytetet euro të Kosovës pra kur janë kthy shihen, shihen p është gjë e natyrshme për arsye se mendohe një ndikim të vetin. Mandej edhe Leonardo e Picasso e ka pasë, por në ndërkohë ato flak që mbetë nën ndikim të tjetërkuj ai do t’jetë

a te cilët kishin studiuar në botën e jashtme
he të cilët gjithë atë bagazh të madh që
ar e kishin sjellë në vendet e tyre, sidomos
kimi edhe një numër i madh i piktorëve tanë
kë, që kanë studiu në Beograd, Zagreb, Lu-
ëve të cilët kanë pasë ndikimin nga, nga stu-
piane. Dhe në fillim të këtyre artistëve tanë
ora ndikimet e profesorëve të tyre. Dhe kjo
et që nga shekulli XIII edhe Giotto ka pasë
e ka pasë dikënd edhe Michelangelo edhe
en edhe atëherë e krijon doktrinën e tij. Ai
i humbur apo jo?”

“The Academy was a very good one with professors in Prague, Munich, Paris and who had collected and brought it to their own places, especially in Europe. The influence was easily noticeable also to a high degree. I studied in Belgrade, Zagreb and Ljubljana, I was influenced by those professors who were influenced by the ones mentioned. And in the beginning of the career you can see the influence of their professors. And this is not true since the thirteenth century Giotto had this influence, as well as Michelangelo and Picasso, but they were [influences] and created their own doctrine. That if someone else will be lost, right?”

professors who had studied abroad, I mean
ected a lot of knowledge in those cities and
Belgrade, Zagreb and Ljubljana. And the in-
number of painters from Kosovo who had
have to mention that they were influenced
their studies in the European cities that I
ers of these artists from Kosovo you could
s is very normal because it is thought that
influence as well. Then Leonardo had some-
ut in the meantime they got rid of those [in-
e ones who remain under the influence of

tition was very strict, at that time there were 18—20 million citizens of that country. And it was difficult, around 300—400 people applied from all around Yugoslavia, and it was very difficult for us Kosovars to stay there for five days during the acceptance exam, we had to go to the homes of students there, I mean to any Albanian, an older Albanian student, and we would sleep two of us in a single bed, for five days. We would travel by train from Pristina to Belgrade, the train was very slow and we were very tired. We had to wait for the day when the results were announced and when we saw that among three hundred—and—something candidates, thirty were accepted in twelve sessions. There were only six people accepted at my university, the University of Belgrade, Department of Graphic Design, and it was a great pleasure.

But Belgrade was a metropolis, a city with big historical traditions, which for two thousand years had been ruled by different empires and it gives big opportunities. It has an extraordinary geographical position, it has two rivers, two big rivers, Sava and Danube, it has the castle of Kalemegdan, many museums, theatres, libraries, it had the Arts and Science Academy, it had diplomatic representatives of many countries that were cultural centres where we could go and read also in Italian, French, English and German.

So there were museums where we could look at all those paintings, not only Yugoslav art but also international art. The works of Picasso, Modigliani were shown at the Museum of Belgrade, there were also exhibitions, we have once also seen the exhibition of Van Gogh, a very big exhibition because there was a time when Belgrade was a metropolitan city where big events took place not only from the sphere of figurative art but there were various fairs during, twelve book fairs for example, I loved the international book fair where I could buy books in for-

eign languages and art history books. So, our horizons could broaden a lot, it was... it was a totally different world, it was a huge contrast to our small city of Peja, but very beautiful nevertheless, right? But, that city had natural beauties as well...

We were accepted at the Academy of Arts, the Academy was a very good one with professors who had studied abroad, I mean in Prague, Munich, Paris and who had collected a lot of knowledge in those cities and brought it to their own places, especially in Belgrade, Zagreb and Ljubljana. And the influence was easily noticeable also to a high number of painters from Kosovo who had studied in Belgrade, Zagreb and Ljubljana, I have to mention that they were influenced by those professors who were influenced by their studies in the European cities that I mentioned. And in the beginning of the careers of these artists from Kosovo you could see the influence of their professors. And this is very normal because it is thought that since the thirteenth century Giotto had this influence as well.

Then Leonardo had someone, as well as Michelangelo and Picasso, but in the meantime they got rid of those [influences] and created their own doctrine. The ones who remain under the influence of someone else will be lost, right? But a big part of these painters of Kosovo, I cannot say a big part, relatively big since I can count them with my fingers, however, have created their own doctrines and came up with very authentic expressions and have their own place in the ivory tower, I can say Pantheon, no matter how small or big, of the entire Louvre of Albanian national art.

EK What were your influences in the art you developed, can you tell us about your work during your studies in graphic design?

SHN I mean in our faculty of arts, for five years, two first years were general knowledge, I mean we learned drawing, painting, sculpture and dis-

Shkollën e Artit, edhe unë sot, sot kisha dhënë kushedi çka sikur vetëm ta shihja se si e kam punu atë, kur drejtori i shkollës e ka vlerësu që duhet t'ia jepë dhuratë dikuj domethanë një musafiri të lartë ushtarak.

Prandej po them që arti është diçka që del nga shpirti i njeriut, me art nuk mund të mirret çdokush, arti figurativ mandej teatri, letërsia ato janë gjëra të cilat u përkasin vetëm atyre që kanë dhunti nga Zoti, apo kanë dhunti nga pedigreeja familjare. Nëse dikush në familje është marrë me art atëherë natyrisht se do të ndikojë edhe, edhe te fëmiju. Por unë nuk e kam pasë as nanën as babën prandej as vet nuk e di se si ka dalë nga unë domethanë talenti për artin figurativ poashtu sikur që del edhe për të gjithë njerëzit e tjerë. Edhe e pashë xhaxhain tim, i cili jetonte atje, ishte drejtor i një institucionit, edhe më takoi tha, "Ku je t'u shku?" Thashë, "Po shkoj të regjistrohem..." Më takoi rastësisht me një bulevard të Beogradit bash në ato momente kur unë po shkoja me u regjistru në Akademinë e Muzikës. Edhe ai më tha, "Jo", tha "po ti e ke kry Shkollën e Artit, ti duhesh të vazhdosh në Akademinë e Arteve". Edhe ai qëlloi ashtu se kushedi çfarë jete do të kisha po të kisha shku në Akademinë e Muzikës.

Edhe unë u regjistrova. Ishte shumë vështirë sepse provimi pranues zgjatë shumë, zgjatë pesë ditë edhe ishte konkurrenca e madhe, ishim në atë kohë rreth 18—20 milion qytetarë të atij shteti. Edhe ishte shumë e vështirë, vinin nga 300—400 konkurent nga mbarë Jugosllavia e na kosovarët e kishim shumë vështirë për me qëndru pesë ditë gjatë provimit pranues na duhej te shkonim në shtëpinë e studentëve atje te ndonji shqiptar, student i yni ma i vjetër, dhe flenim për shembull me një shtrat nga dy vetë, nga pesë ditë për me arritë. Udhëtonim nga, nga Prishtina për në Beograd me tren, treni udhëtonte shumë ngadale, ishim të lodhur. Duhej me pritë ditën kur shpallej, kur shpallej domethanë rezultati dhe kur e shihnim na se në

mesin e 300 e sa kandidatëve na ishin pranuar tridhjetë e sa në dymbëdhjetë seksione. Në fakultetin ku isha unë të Universitetit të Beogradit dhe në degën e Dizajnit Grafik ku u pranova unë ishin vetëm gjashtë vetë kështu që ishte një, një kënaqësi e madhe.

Mirëpo Beogradi ishte një metropol, i cili është një qytet me traditë të madhe historike të cilën e kanë sundu gjatë historisë për 2000 vjet shumë, shumë perandori të ndryshme dhe jep mundësi të mëdha. Ka një shtrirje gjeografike të jashtëzakonshme, i ka dy lumenjë, dy lumenjë të mëdhenjë Savën dhe Danubin, e ka kështjellën e Kalemegdanit, ka shumë muze, ka teatre, ka biblioteka. Kishte Akademinë e Shkencave dhe Arteve, kishte përfaqësinë diplomatike të shumë shteteve të cilat kishin qendra kulturore ku ne mund të shkonim dhe të lexonim edhe në italisht, edhe frengjisht edhe anglisht edhe gjermanisht.

Kishte pra po them muze, ku mund t'i shikonim të gjitha ato piktura, jo vetëm artin Jugosllav por kishte edhe art ndërkombëtar, muzeu i Beogradit kishte, i kishte veprat e Picassos, Modiglianit ekspozoheshin edhe ekspozita, na e kishim parë një herë edhe ekspozitën e Van Goghut, ekspozitë shumë e madhe se një kohë ishte bërë Beogradi një, një qytet metropolitan edhe ndodhnin ngjarje të mëdha jo vetëm nga fusha e arteve figurative por kishte panairë të ndryshme gjatë, dymbëdhjetë panairë të, për shembull të librit, mu m'pëlqente panairi i librit ndërkombëtar kur mund të bleja libra në gjuhë të huaja edhe të historisë së artit. Pra horizontet tona mund të hapeshin me të madhe, ishte pra... ishte pra një botë krejt tjetër, ishte një kontrast i madh me qytetin tonë të vogël të Pejës, por shumë të bukur apo jo? Mirëpo edhe ai qytet i kishte edhe bukuritë natyrore.

U futëm në Akademinë e Arteve, Akademia ishte shumë e fortë, me profesora te cilët kishin studiuar në botën e

ciplines, life drawings, nudes and so on... and others, others, those were mutual. After the second year, that is when we would choose a major. There were twelve sessions, I mean twelve departments, and I decided to go to the Department of Graphic Design since we had no one coming from this field in Kosovo. But this is not the reason I decided to go to graphic design, because I only found out later that there was no one coming from this field in Kosovo, an educated artist in the field of graphic design, but I liked it, I liked it because design has something more than painting or drawing or sculpture.

In order to be a designer you have to be an excellent drawer and painter, you have to feel the color, you have to be, to feel the volume, I mean there is a third dimension. You have to have feelings for the sculpture as well but above all, design has an artistic message, it uses metaphor and it has to communicate. Because when we create a painting, graphic, drawing, sculpture that can be sold to a private person or to a gallery and that is it, there is nothing else, that is unique, while in design we have *tiraž*,¹⁵ graphics has *tiraž* as well but it is very limited, ten to twenty, thirty serigraphs for example, screen prints [in English] as American call it, that can have one hundred to two hundred copies because somehow that turns into a graphic industry. While aquatint, graphics, I mean the graphics of deep press, copper—writing, *mezotinta*, have a limited *tiraž* and since the *tiraž* is limited, once twenty or fifteen copies are printed, then with a commission they get scratched and cancelled so the author cannot print more, otherwise they lose their value, don't they?

While in design for example the poster which in French is called *affiche* and in German *plakat* has a very big *tiraž* and it communicates to millions of people, those people can be intellectuals, pseudo—intellectuals or illiterate. But they will understand what it talks about

when they see the visual part, if we have a theatre play poster or a movie poster, or with political ones they are very important to give political messages. We also have the posters against the war and that is when, I mean those figurative metaphors should be very powerful in order to be read. That is why I always liked posters, and I always liked logos or emblems because later on I studied and also wrote books about the Albanian Heraldica because we also have our emblems, which are the oldest in Europe. Especially the emblem of *Kastrioti*¹⁶ which is, it has the shield, in heraldica it is known as a Norman shield from the eleventh century.

That is why these all inspired me to engage. Just because everything there should be precise, an abstract poster cannot be made because it is worthless, it has no function, while in painting and graphic design we have fun, we go to the studio, we have the cloth and we paint whatever our soul wants us to, we don't depend on anyone, while in poster—making, in logo—making, there are commissions. Imagine that you have to work, you have to defend your project in front of a commission. There should be five people, there can be seven as well as eleven and some of them can be educated while others can be totally illiterate in the field of aesthetics and that is where you may have very harsh confrontations.

That is why I liked it and decided to engage in design and then I have worked in the People's Theater of Belgrade for four years, for the Opera, for the ballet and dramatic arts, I have also done illustrated books. For example, [Sergei] Yesenin, the collection of books that was published in Yugoslavia for the first time, I painted its covers and I won the award of the Belgrade fair for the best collection, so I am very pleased about engaging in design. And I had the strength, because design also needs intelligence, one needs to read a lot, to know a lot, because

15

Russian: *tiraž*,
printing.

16

Gjergj Kastriot – Skanderbeg (1405-1468) was an Albanian nobleman and leader. Taken hostage as a boy by the Ottomans, he served the Empire until 1443 when he became the Chief of the League of Albanian People in the League of Lezhë. He led a resistance to the Ottoman Empire for the next 25 years until his death, and is considered a model of Christian resistance against Ottoman Islam throughout Europe. He is the greatest Albanian national hero.

jashtme domethanë në Pragë, në Minhen, në Paris dhe të cilët gjithë atë bagazh të madh që kishin vjelë në ato qytete dhe që kishin mësuar e kishin sjellë në vendet e tyre, sidomos në Beograd, Zagreb, Lublanë. Dhe shihej ndikimi edhe një numër i madh i piktorëve tanë të Kosovës që kanë studiu, këta duhet ta cekë, që kanë studiu ne Beograd, Zagreb, Lublanë kanë marrë ndikimin e atyne profesorëve të cilët kanë pasë ndikimin nga, nga studimet e tyre në, që i thashë këto qytetet europiane. Dhe në fillim të këtyre artistëve tanë të Kosovës pra kur janë kthy shihen, shihen pra ndikimet e profesorëve të tyre. Dhe kjo është gjë e natyrshme për arsye se mendohet që nga shkekulli XIII edhe Giotto ka pasë një ndikim të vetin.

Mandej edhe Leonardo e ka pasë dikënd edhe Michelangelo edhe Picasso e ka pasë, por në ndërkohë ato flaken edhe atëherë e krijon doktrinën e tij. Ai që mbetë nën ndikim të tjetërkuaj ai do t'jetë i humbur apo jo? Mirëpo një numër i madh i këtyre piktorëve të Kosovës, nuk mund të them i madh, relativisht i madh meqë mund të ngjehen me gishta. Megjithatë, e kanë krijuar domethanë doktrina edhe shumë origjinal vijnë, dhe e kanë zënë vendin e tyre në panteonin, mund të themi panteonin, sado i madh apo i vogël të artit mbarëkombëtar shqiptar.

EK Çka ishin ndikimet e juja në artin e juaj që e zhvillojshit, a mundeni me na kallxu pak për punën e juaj gjatë studimeve në dizajnin grafik?

SHN Po, do të thotë që në fakultetin tonë të arteve, për pesë vjet, dy vjetët e para kanë qenë të përbashkëta, domethonë më mësonin vizatimin, pikturën, skulpturën dhe disiplinat, aktin, nude që i thojmë apo jo... e tjera, e tjera, ato kanë qenë të përbashkëta. Mbas vitit të dytë, atëhere na orientoheshim. Kanë qenë dymbëdhjetë seksione, do të them dymbëdhjetë domethonë departamente apo katedra dhe unë u vendosa të shkoj në, në katedrën e dizajnit grafik,

meqë, meqë nuk kishim në Kosovë asnjë që ishte në këtë fushë. Po nuk ishte kjo që kisha menduar për këtë çështje por ma vonë e kuptova që nuk kishte asnjë nga kjo fushë në Kosovë, ndonji artist i shkollum në fushën e dizajnit grafik dhe unë, më pëlqente, më pëlqente për arsye se dizajni ka diçka më tepër se sa ka për shembull piktura ose vizatimi apo skulptura.

Për të qenë dizajner duhet me qenë vizatues i shkëlqyeshëm, piktor i shkëlqyeshëm, duhet ta ndjesh ngjyrën, të jesh, ta ndjesh volumenin domethonë dimenzionin e tretë me njëfarë mënyre të jesh. Të kesh ndjenja edhe për skulpturë, por mbi të gjitha dizajni e ka porosinë artistike, e ka metaforën dhe ai duhet patjetër të komunikojë. Për arsye se kur e krijojmë një pikturë, një grafikë, një vizatim, një skulpturë ajo mund të shitet te një person privat apo mund të shitet për një galeri. Dhe me kaq, nuk ka tjetër ajo është unikale kurse në fushën e dizajnit ekziston tirazhi, po edhe grafika e ka tirazhin e vet mirëpo ajo e ka të kufizumë, dhjetë dej në njëzetë, tridhjetë. Serigrafia, për shembull screen që i thojnë amerikanët ajo mund ta ketë edhe njëqind—dyqind kopje për arsye se ajo po, po shndërrohet pak në industri grafike. Kurse akuatinta grafika domethanë e shtypit të thellë, bakërshkrimi, mezo-tinta, ato e kanë tirazhin e kufizumë dhe meqë e ka tirazhin e kufizumë, masi që të shtypen 20 apo 15 kopje. Atëherë me një komision ato grrithen anulohen që ma autori nuk guxon të shtypë se përndryshe ato ta hupin vlerën, apo jo.

Kurse në dizajn, për shembull posterit që i thojnë frëngjisht affiche apo në gjermanisht plakat e ka tirazhin shumë t'madh ai komunikon me miliona njerëz, ata njerëz mujnë me qenë intelektual, mujnë me qenë pseudo—intelektual, mujnë me qenë analfabetë njerëz. Por kur ta sheh pjesën vizuale ai duhet të kuptojë se për çka është fjala, nëse e kemi një poster teatral apo filmik apo sidomos këta politik janë shumë, shumë të randë-

every task for example, I was given the task to work on the poster for *Il Trovatore* of Giuseppe Verdi for the Theatre of Belgrade. And that is when I first had to read the libretto in order to know, but if I didn't know the music of Giuseppe Verdi or I hadn't gone to the opera of Belgrade I wouldn't have been able to work on the poster, I would have failed. I listened to the operas a lot and I knew that the event was taking place in Spain.

Then when we read a poet, later on I got to illustrate for all the poets of Kosovo, I read all of them, I also illustrated other international poets whom I liked. So, you know, in my mind I knew I had to enrich myself as much as possible, because the more we read, the more we get to see, we will be more able to express ourselves with better quality.

EK For how long did you stay in Belgrade?

SHN The Academy in Belgrade lasted for five years then I applied and was the only one to get accepted for two more years for a master's degree, that was a very good time, extraordinarily good. Because my master's was very good compared to nowadays master's with the Bologna formula which has the same subjects as the first, second and third year of bachelor's. So students tend not to have a commitment, we only had one subject. For two years I only dealt with my subject and this was something... because five years of faculty, then two other years.

And I also told you earlier that I continued in Japan for two years and that was an extraordinary time where I gained experience in creativity as well as in knowledge about art history, because in Japan I would only research. I was interested in Japanese haiku poetry, which is written in three lines with seventeen vowels and starts from the sixteenth—seventeenth century, then I went to meet the best Japanese graphic artists who worked in the *ukiyo-e* graphic style. I mean, the genres, the everyday Japanese

life genres where there are Hokusai, Hiroshige, Utamaro, these are three extraordinary painters who have worked... graphics with twelve plaques, I mean out of cherry trees, they are extraordinary.

Then I also visited the greatest contemporary painting exhibitions in Japan. *Nihonga*, this is how they call it, *Nihonga*. The Japanese—style paintings, they still continue to do them, maybe 80—90 percent of them work in the Japanese style while only a small number of them deal with contemporary art. But also the posters, artistic photography is well developed there, I have seen many friends there, I have met for example the best Japanese designer who is called *Tadhana Orioko* and the photographer *Kishin Shinoyama*, these two artists are both number one in Japan. One of them works in poster design while the other in artistic photography, so while in Japan, I expanded and developed my horizons in every possible way.

EK Was the visual language very different, was it easy for you to communicate with those design principles?

SHN Yes, I forgot to mention that during those two years, first I went to Osaka for six months for an intensive Japanese language course. So, I had to learn Japanese for almost, almost eight hours a day and it was something very difficult to do. And I, Erëmira [addresses the interviewer], to tell you the truth, in the beginning I had a friend from Croatia and two girls from Yugoslavia, *Amelita* and *Tamara*, who were studying architecture there. As soon as I arrived there I started, I said let's go with the Dalmatian, his name was *Ivan*, and I said let's go and have some adventures in Kyoto, the capital of Japan, let's go to *Nara* then to *Karazu Island*, in southern Japan.

Japan has four big islands, there is *Hokkaido*, *Honshu*, *Kyushu* and *Shikoku*, all these four islands and 4,000 small, uninhabited islands, and we went there on adventures with

But as the time passed, that liberation of the Albanians didn't have a long life. The new Yugoslavia was created, a shop was opened in Peja, Knjižara³ was written in big letters. I bought a drawing block, on the first page of which was written Blok broj jedan [Drawing Block, number one]. I mean it was after the war and I say, some say, after the liberation, but I don't agree with that thought. I bought a drawing block and some watercolors with a small brush, I started painting everything that surrounded me. I started going out in the neighborhood and painted some old small houses, some big wooden doors, then I also went out in nature. In Peja we have a hill that is called Tabje, it is beautiful during the whole year, nature makes it beautiful. Then I went and drew Rugova Canyon, the Patriarchate of Peja as a religious building... and some other buildings.

But I had a preoccupation, how to understand living nature, the human figure, limbs, the physiognomy of the human head... I would walk around in Peja's markets with a purse on my shoulders, some typewriting machine paper and some other helpful tools. I mostly went to the Green Market. From the villages on market days they would bring the agricultural products in some big baskets and small full of agricultural items.

Owners themselves were wearing traditional clothes quite usual for the '50s, '60s. And I, quickly filled with joy started drawing that beautiful view. Then I often went to the bus station, it was more difficult for me to draw there because the travellers would always move. But, a little based on my memory and a little based on nature, the drawings I did were a sort of croquis figures.

I felt a lot better when I went to the train station; I went there during winter, summer, rain and snow and I usually found

1 Rreth (circle) is the social circle. It includes not only the family but also the people with whom an individual is in contact. The opinion of the rreth is crucial in defining one's reputation.

2 Lagje in this context means just neighborhood, but more specifically, in the traditional tribal organization of northern rural Albanians, it refers to a group of families sharing a common ancestor.

3 Serb: Knjižara, bookshop.

Pjesa e Parë

EK Zoti Xhafa, a mundesh me na tregu për kujtimet tua të hershme, rrethin ku jeni rritë edhe familjen në të cilën keni jetu?

XHXXH Po. Si fillova, me folë, me u rritë edhe fillova me vizatu. Më kujtohet mirë, pranvera e madhe e vitit 1941, Lufta e Dytë Botërore. Siç e dijmë, ish—Jugosllavia kapitullon ndaj Gjermanisë. Me kapitullimin e ish—Jugosllavisë, edhe gjysma e tokave Shqiptare shlirohet nga okupimi gati 30 vjeçar, serbo—sllav. Më kujtohet në Pejë ishte një festë e madhe, fillon arsimimi në gjuhën Shqipe. Me dhjetëra mësues vijnë nga Shqipëria e sotme, për të ndihmuar arsimin shqip në Kosovë, në trojet e shlirume.

Unë isha në klasën e parë, në klasë ishim shumë nxanës, ne nxanësit kishim nga dy fletore. Unë e doja shumë vizatimin. Para se të filloj të mësoj në shkollë, kom vizatu nëpër muret e lagjes. Edhe në këto dy fletore, fillova me vizatu. Një ditë mësuesi më tha, "Këto fletore janë për me shkru", unë i thashë, "Unë e dua vizatimin". "Ani, po ta mundësoj faqen e parë të fletës për me shkru, e faqen e dytë vizato". Unë e ndigjova edhe fillova ashtu si më udhëzoi. Mirëpo, ato shenjat e lapsit u dukshin edhe faqen e parë të fletës. Heshti mësusi...

Mas dy—tri ditëve hyj në klasë, drejt vjen te banka ime, me veti ka sjellë tri fletore edhe më thotë, "Djalo, ndigjo! T'i kom pru tre fletore, dy fletore jonë për me shkru, në këto dy fletore jo me vizatu, qe këtë fletore pa vija munësh me vizatu". Edhe unë, shumë u gzova, fillova në atë fletore pa vija me vizatu, gjithçka ça kishna afër. Dëshira ime ishte me vizatu kafshë shtëpiake, e kisha afër. Çdo familje, në lagje dhe në qytezë, kishin ka një, dy, tre, kafshë, se gjendja sociale te banorët ishte shumë e randë... ajo gjendje e randë sociale edhe është përjetu në familjen tonë.

Mirëpo, me kalimin e kohës, ai farë shkrimi për shqiptarët nuk

pati jetë të gjatë. U krijua Jugosllavia e re. Në Pejë hapet një dyqan, me shkronja të mdhaja shkrunte Knjižara [Libraria]. Unë e blej një bllok vizatimi, ku shkrunte në faqen e parë Blok broj jedan [Bllok numër një]. Domethonë ishte pas lufte unë thom, dikush thotë pas shlirimit, unë me këtë mendim nuk pajtohem. E blej një bllok t'vizatimit pra, një parë ngjyra uji, me një brushë të vogël filloj me pikturu gjithçka ça kishna afër. Dal në lagje filloj me pikturu, disa shpija të vjetra, të vogla, disa dyrë të mëdha prej drunit, ma vonë dal në natyrë. Në Pejë e kemi një bregore që thirret Tabje, ajo gjatë tanë vitit është e bukur, natyra e zbukuron. Mandej kam shku e kom vizatu grykën e Rugovës, Patriashinë e Pejës si objekt fetar... edhe disa objekte tjera.

Mirëpo, te unë ishte një preokupim, si ta kuptoj natyrën e gjallë, figurën e njeriut, gjymtyrët, fizionominë e kokës të njeriut... me një strejçë, në krahë me disa fleta maqine, e mjete tjera ndihmëse, filloj të shetis në disa tregje të Pejës. Ma së shpeshti jom dalë në tregun e gjelbërt. Nga fshatrat në ditë pazari i bijshin prodhimet bujqësore me do kosha të mëdha e të vogla përplot me artikuj ushqimor.

Vetë pronarët ishin veshë me ato veshje tradicionale, që ishin aktuale për vitet '50—ta, '60—ta. Edhe unë, me shpejtësi, me kënaqësi, fillojsha shpejt e shpejt, me realizu me vizatu atë pamje të bukur. Mandej shpesh kom shku edhe në stacionin e autobusave... aty pak ma vështirë e kom pasë me vizatu, pse udhëtarët gjithnjë lëvizshin. Mirëpo, pak simbas kujtesës pak simbas natyrës, ato vizatime që i bojsha ishin si një lloj kroki¹.

Shumë ma mirë e kom ndi vetën kur kam shku në stacionin e trenit, kam shku dimnit, verës, në shi, në borë edhe shpesh udhëtarët i kom gjetun me orë të tana t'u e prit trenin, e udhëtarët e lodhun i shifsha grumbuj, të shtrimë në pozita të ndryshme. Për mu ishte joshëse, çdo pozitë e udhëtarëve, e afërt për m'i

1
Croquis, skicim i figurës trupore.

the travelers waiting long hours for the train, tired travelers, I saw them in crowds lying in various positions. To me it was attractive, every position of the travelers, very close to be drawn... and so for six, seven years of my work, I welcomed every free activity. Not only did I understand living nature, the human figure, limbs, but I gained the courage of expression, the honest, natural courage, without using the stimulating stimulants which were and are still used by several artists.

I was always restless as an artist... I started learning about the history of the Albanian nation through living memory, those thoughts inspired me. I thought about how to understand and get along with the humans, with myself, to help this with art, not to allow myself to remain a slave to color but a slave to myself, to the humans of this land. I started being inspired by those closest to me, by the autochthonous architecture, especially that of Dukagjin, I am talking about Dukagjin because I was born and raised in Dukagjin.

I often went to visit various architecture in various cities, I mostly went to Gjakova because there was a more or less isolated architecture, but with artistic values, the architecture of Gjakova is directly connected to the environment, humans, nature. I also went to Prizren, the architecture there is less autochthonous, as we know Prizren was a bridge that connected the nations of Balkans, it was normal that its culture was interrupted by some other cultures, but those cultures were injected into the local architecture. And so even today, the architecture of Prizren is amazing, it is directly connected to nature, people, humans.

I was always in a kind of depression. Then we had more valuable architecture, with a longer life, those are the kulla⁴ of Dukagjin, for example the kulla of Strelc, Lubeniq, Isniq and many other buildings where Albanians used to

and still live and that are very valuable artistically. If we draw a man with traditional clothes next to the kulla of Dukagjin, we will see that these two physiognomies unite, we will have one single physiognomy... then I was inspired and I used the rich and honest folklore that we have; as we know the Albanian folklore has for centuries been transmitted from generation to another.

The layers, decorations that were embroidered in the traditional clothes were done so by healthy, honest human minds; in these layers, as we know, the black color dominates, this color is directly connected to the physiognomy of the Albanian nation, it is a convincing, strong, traditional color. I started dealing with sports as well but I didn't feel good with myself, I was restless... when I was dealing with gymnastics, more with running (coughs), my favorite path to run was the one in Rugova Canyon. I would run slower on the uphill part of this path, while much faster on my way back down; my legs would move themselves downhill.

While going to and returning from this path, I always had my mind and my eyes directed towards the cliffs of the Rugova Canyon, such a splendor could only be created by nature and left to us. I took something from those cliffs and showed it in my works. Nature helped me to get engaged in art, it led me to love art. I easily expressed my preoccupations with the tools I had close to myself, I had them in my surroundings... I lived with them, I know their physiognomy very well and I expressed my feelings, my concerns directly through those tools. I have tried to give a biographical glimpse of my artistic activity through words. Thank you!

EK Mister Xhafa, can you tell us where did you first engage, the first formal steps that were... where did you get the education, did the Shkolla e Artit in Peja⁵ exist at the time?

XHXH Yes, the Shkolla e Artit existed in Peja, it was established

4 Literally tower, the Albanian traditional, rural, fortified stone house.

5 Shkolla e Mesme e Artit, the Arts High School in Peja was built in 1926 and opened in 1949. The first generations of visual artists in Kosovo received their education in figurative and applicative arts from this institution. This education enabled the artists to continue higher education in arts. The historical building of the Arts High School in Peja was destroyed in August, 2017.

vizatu... edhe kështu gjashtë, shtatë vite të punës sime, aktiviteteve të lira, për mu ishte e mirëseardhun. Jo vetëm që e kuptova natyrën e gjallë, figurën e njeriut, gjymtyrë, por u shtua edhe guximi i shprehjes, guximi i sinqertë, guximi natyral, pa përdor ato medikamente stimuluse siç dje dhe sot disa artistë i përdorin.

Isha gjithnji jo i qetë si artist... fillova të mësoj për historinë e kombit shqiptar nga fjalët e gjalla, ato mendime më inspiruan. Mendoja si ta kuptoj, ma mirë të mishnohesha me njeriun, me vetveten, me art ta ndihmoj. Vendosa mos të jem mo rob i ngjyrës, por të jem rob i vetit, i njeriut të këtij trolli. Fillova të inspirohna me atë që kom ma së afërmi, me arkitekturën autoktone, sidomos të Dukagjinit, po thom Dukagjinit jom përcaktuar pse kom lind në Dukagjin edhe jom rritë në Dukagjin.

Kom shku shpesh me vizitu arkitektura të ndryshme, në qytete të ndryshme sidomos ma së shumti jom përcaktu për Gjakovë, se aty ka qenë një arkitekturë pak a shumë e mbyllun, mirëpo me vlera arti, arkitektura drejtpërdrejt lidhet me atë të Gjakovës, me ambientin, njeriun, me natyrën. Kom shku edhe në Prizren, aty arkitektura pak ma jo autoktone, siç e dijmë Prizreni ka qenë urë lidhëse e popujve të Ballkanit, e aty ka qenë normale që kanë ndërhy disa kultura tjera, mirëpo edhe ato kultura qe kanë ndërhy jonë mishëru me arkitekturën vendore. Edhe kështu edhe sot arkitektura Prizrenit është madhështore, lidhet drejtpërdrejtë me natyrën, me njeriun, me njerëzit.

Isha gjithnji në një lloj depressioni. Mandej kemi një arkitekturë edhe ma të vlefshme, ma jetëgjatë, ato jonë kullat e Dukagjinit, si për shembull kullat e Strelcit, Lubeniqit, Isniqit e shumë objekte tjera ku kanë jetu shqiptarët e ku jetojnë shqiptarët, që kanë edhe vlera arti. Po ta paraqesim, paraqitet një njeri me veshje tradicionale afër kullës, Dukagjinit, kemi me pa që këto dy

fizionomi bashkohen, kemi me pasë një fizionomi... mandej jom inspiru edhe jom frymëzu edhe i kom përdor folklorin që e kemi të pasun, të sinqertë. Siç e dijmë folklori shqiptar është përcjell me shekuj, gjeneratë mas gjenerate te popullata shqiptare.

Larat, dekorimet që jonë dhonë në veshjet tradicionale jonë dhonë nga mendja e shnoshë, e sinqertë e njeriut. Në këto lara, siç e dijmë prezent është ose dominuse ngjyra e zezë, kjo ngjyrë drejtpërdrejtë lidhet me fizionominë e kombit shqiptar, është ngjyrë bindëse, ngjyrë e fortë, ngjyrë tradicionale. Kom fillu të mirrem edhe me sport, nuk e nijsha vedin mirë, s'isha i qetë... kur jom marrë me gjimnastikë, ma shumë me vrapim (kollitet) rruga ma e dashun e vrapimit për mu ka qenë rruga e Grykës së Rugovës. Përpjetëzës të kësaj rrugës vrapojsha ma ngadale, t'u u kthy shumë ma shpejt, teposhtëze kam të shkojshin vet.

T'u i shku kësaj rruge e t'u u kthy, gjithnji mendja dhe sytë më shkojshin kah shkambijtë e Grykës të Rugovës, atë madhështi vetëm natyra ka mujtë me kriju edhe me na lanë. Nga ato shkambij edhe une kom marrë diçka dhe e kom paraqitur në veprat e mija. Mua natyra më ka ndihmu të mirrem me art, natyra më ka udhëzuar ta doja artin. Preokupimet e mija i kom shprehur me lehtësi, me mjete që i kom pasë afër, rreth e përçark i kom pasë... kom jetu me to, e njoh mirë fizionominë e tyre edhe drejtpërdrejtë me ato mjete unë kom shpreh ndjenjat, shqetësimet e mija. U mundova me pak fjalë me dhonë një grimcë biografie të veprimtarisë sime, artistike. Faleminderit!

EK Zoti Xhafa a mundesh me na tregu kur je marrë ma s'pari, hapat e parë kshu ma formal që kanë qenë, edukimin ku e ke ba, a ka ekzistuar atëhere kjo Shkolla e Artit në Pejë?

XHXXH Po, ka ekzistuar Shkolla e Artit në Pejë, u formu në 1948, une kom qenë gjenerata e pestë, ka qenë shkolla e fortë e artit

“... te unë ishte një preokupim, si ta kuptoj na fizionominë e kokës të njeriut... me një strejë tjetra ndihmëse, filloj të shetis në disa tregje të gun e gjelbërt. Nga fshatrat në ditë pazari i mëdha e të vogla përplot me artikuj ushqimorë.

Vetë pronarët ishin veshë me ato veshje tradicionale '60—ta. Edhe unë, me shpejtësi, me kënaqësi vizatu atë pamje të bukur. Mandej shpesh kishim aty pak ma vështirë e kom pasë me vizatu, për shkak të simbas kujtesës pak simbas natyrës, ato vizat.

tyrën e gjallë, figurën e njeriut, gjymtyrët,
ë, në krahë me disa fleta maqine, e mjete
të Pejës. Ma së shpeshti jom dalë në tre-
vijshin prodhimet bujqësore me do kosha të
or.

dicionale, që ishin aktuale për vitet '50—ta,
si, fillojsha shpejt e shpejt, me realizu me
om shku edhe në stacionin e autobusave...
ose udhëtarë gjithnjë lëvizshin. Mirëpo, pak
atime që i bojsha ishin si një lloj kroki”.

"... I had a preoccupation, how to understand the physiognomy of the human head... I would walk on my shoulders, some typewriting machine on my back, I went to the Green Market. From the village I brought agricultural products in some big baskets and...

Owners themselves were wearing traditional clothing. I, quickly filled with joy started drawing quickly. At the bus station, it was more difficult for me to draw, I always move. But, a little based on my memories, the drawings I did were a sort of croquis figures."

and living nature, the human figure, limbs, the
walk around in Peja's markets with a purse
paper and some other helpful tools. I most-
es on market days they would bring the ag-
small full of agricultural items.

l clothes quite usual for the '50s, '60s. And
kly that beautiful view. Then I often went to
o draw there because the travellers would
ory and a little based on nature, the draw-

in 1948. I was the fifth generation, the Shkolla e Artit was very strict, it was even the second best school in former Yugoslavia when there were around seven or eight middle schools. I mean, there was the Shkolla e Artit where we all learned, not as much from the professors as from nature. Nature inspired us to say things honestly, to express our knowledge on the canvas.

EK What kind of visual school was it, at that time?

XHXXH It was not much of a painting school, there, the arts were a little limited, but it was strong, many generations have graduated from it and today they are among the famous names that represent the Kosovo arts. It was more or less, if we compare it to current schools, a classical school, but it was a strong one, sustainable. I took my first steps there, then since the education there was a little limited, nature was present... I had, I was a little old, I had the power to do something more but we had no courage. I went to Ljubljana for my studies, I happened to have a good professor, Gabrijel Stupica,⁶ who at the time was considered an academic painter, this is what he was considered by Italians.

And I started getting comfortable to express what I knew, the professor was surprised, he would say, "Good, good, good!" They provoked me once when they said, "Can you show nature the way it is?" I said, "Yes." And when I did so that is when he left me to work, they didn't interrupt me at all. Because they knew I had an artistic sensibility, I loved art and so I started being courageous to go on and so I started with my works. Only later did I show up with my paintings, I was withdrawn, limited, because I lacked the courage to show my opinions.

But, many critics came from former Yugoslavia to see what was happening in Kosovo and when they came to me they would say, "Good, good, good!" So the courage in me started strengthening. I never (coughs) was part of any

competition, they invited me to exhibitions be it biennials or triennials in former Yugoslavia. But also when exhibitions took place abroad, organized by the Zagreb or Ljubljana museum I was invited. I saw there or someone told me that the newspapers wrote and they distinguished me, three, four, five, ten people and I among them, so this is how I started getting more courageous.

EK Mister Xhafa, how did you go to Ljubljana at that time, I mean who encouraged you, who supported you to go to Ljubljana. Can you tell us what kind of art did they teach you there?

XHXXH I decided to go to Ljubljana, I didn't even attempt to apply in Belgrade, my friends always went to Belgrade, some had success and some others not. I went to Ljubljana with the aim to as rarely as possible return to my homeland (laughs), to be present, to work, to give everything from myself, I don't know, my abilities and I came to such point that they valued it. There was one moment when the rectorate took four or five of my works in order for them to be seen by whoever would come, for the guests to see a pure art. It is my opinion and I still say that nowadays honest art is valued, the new works as well but also the honest ones, and the value of being present is understood.

EK What about when modernism became famous in painting, I mean did they ask you to make socio—realist paintings in the Shkolla e Artit in Peja or what kind of art genres?

XHXXH The Shkolla e Artit in Peja was a classical one, it was the nature of describing nature, they wouldn't allow you to do anything else, and I had the will since I was a little older to say something more. One moment I started saying something, what I thought was right, but they didn't allow me. When I went to Ljubljana I was met with understanding, they supported me. Modernism had started long ago, one century ago but...

EK In Kosovo?

6
Gabrijel Stupica (1913—1990) was born in Dragose, Slovenia. He studied at the Academy of Fine Arts in Zagreb. His art was influenced by his visit to a Tizian exhibition in Venice in 1937 and an exhibition of masterpieces from the Prado in Geneva in 1939. In 1946 he became a full time professor of painting at the Academy of Fine Arts, in Ljubljana which has just been established.

bile në atë ish—Jugosllavi, ka qenë shkolla e dytë se kanë qenë njo shtatë—tetë shkolla të mesme. Domethonë ka qenë Shkolla e Artit krejt ne aty kemi mësu, jo nga profesorat aq sa nga natyra. Natyra ka ndiku që ne të inspirohemi ta thomë në mënyrë ma të sinqertë, ta shprehim atë diturinë tonë në pëlhurë.

EK Çfarë shkolle e pikturës ka qenë ajo, në atë kohë?

XHXXH Ajo ka qenë pak shkollë e pikturës, në të vërtetë arti pak a shumë i kufizim, mirëpo ka qenë e fortë, që shumë gjenerata që kanë kry aty, sot jonë edhe kanë emra që përfaqësojnë artin kosovar. Ka qenë një shkollë pak a shumë me këtë kohën e sotme, klasike, mirëpo ka qenë shkollë e fortë, e qëndrueshme. Hapat e para pra i kom marrë aty, mandej meqenëse edhe aty ishte edukimi pak i kufizim, natyra ishte prezent... unë kishna, isha pak në moshë, kishna edhe unë fuqinë ma shumë diçka, mirëpo s'kishim guxim. Shkova në studime, Lublanë, qëllova te një profesor i mirë, fati nga Gabrijel Stupica², që e konsiderojshin atëhere intelektual në laminë e pikturës, italianët e kanë konsideru.

Edhe unë fillova m'u shliu. Çka di, m'u shpreh, profesori u habitke thojke, "Mirë, mirë, mirë". Një provokim ma kanë bo, "A mundesh me paraqitë natyrën si është?" Thojsha, "Po". Edhe kur e paraqita atë, ai më udhëzoi atëhere më lëshoi me punu, nuk m'kanë pengu fare se e dinte që kom një nerv arti, e dua artin. Edhe kështu fillova me marrë një guxim dalë ngadalë edhe fillova ato punët e mija. Vonë jom paraqitë me pikturat e mia, kom qenë i mbyllur i kufizim pak, se e kisha që më mungonte guximi m'u paraqitë në opinion.

Mirëpo, t'u ardhë kritikë të ndryshëm nga ish—Jugosllavia me pa çka po ngjanë në Kosovë, kur vishin te unë, "Mirë, mirë, mirë!" Edhe guximi te unë filloi edhe me u forcu. Asnjëheri (kollitet) nuk kom marrë pjesë në konkurs, por gjithnji më kanë ftu në këto ekspozita,

qoftë bienale, triennale ish—Jugosllave. Madje, po ashtu, në botën e jashtme kur kemi ekspozitu, që ka organizu muzeu i Zagrebit apo Lublanës apo me grupe mu më kanë ftu. Edhe bota e jashtme kom pa aty këtu ose më ka tregu dikush që po shkrun gazeta, edhe mu më kanë veçu, tre, katër vetë, pesë vetë, dhetë vetë, në mes tyre edhe unë. Edhe tash te une filon guximi edhe ma fortë.

EK Zoti Xhafa qysh shkut në Lublanë në atë kohë, po mendoj kush ju shtyu, kush ju mbështeti me shku në Lublanë. A kish mujt me na tregu çfarë stili në art ju kanë mësu atje?

XHXXH Vendosa me shku në Lublanë, në Beograd as që kom provu me konkuru, shokët e mi gjithmonë kanë shku në Beograd, disa kanë pasë sukses, disa jo. Kom shku në Lublanë me qëllim sa ma rrallë m'u kthy në vendlindje (qesh), me qenë aty prezent, me punu, me dhanë krejt prej vetit, çka di, ato aftësitë e mija. Edhe aty erdha në çfarë shprehje që ma vlerësun. Bile edhe një moment ishte, në katër, pesë punime në rektorat, i kanë marrë me ia, për me pa kushdo që vjen prej musafirëve, me pa një art i pastërt. Mendimi im edhe tash thom, sot, po vlerësohet arti i sinqertë, po edhe risia, mirëpo i sinqertë edhe kuptohet vlera me qenë prezent.

EK E kështu, kur u përhap si formë modernizimi në pikturë, po mendoj edhe në këtë shkollën e Pejës, a ju shtijshin me pikturu në stilin socio—realist, apo çfarë rryma ishin atëhere?

XHXXH Shkolla e Pejës ka qenë një shkollë klasike, ishte natyra për me përshkru natyrën, edhe diçka ma tepër nuk lejojshin. E unë kisha vullnet me thonë se isha pak në moshë me thonë diçka ma shumë. Në një moment fillova diçka me thonë, ato që ma merrke mendja mirë, mirëpo nuk më lejun. E kur shkova në studime në Lublanë, gjeta një mirëkuptim, fillunë me më përkrah, e modernizmi ka fillu kahere, para një shekulli po...

EK Në Kosovë?

XHXXH Në Kosovë? Çka me thonë,

2
Gabrijel Stupica (1913—1990) u lind në Dragose, Slloveni. Ai ka studiuar në Akademinë e Arteve të Bukura në Zagreb. Puna e tij artistike ka qenë i ndikuar nga një vizitë që kishte pasur në ekspozitën e Tizian në Venedik, më 1937 dhe një ekspozitë të kryeveprave të Prados në Gjenevë më 1939. Më 1946 ai bëhet profesor i rregullt i pikturës në Akademinë e Arteve të Bukura në Lublanë, e cila asokohe sa ishte themeluar.

XHXX In Kosovo? What do I say, it started, I say, maybe with me a little (laughs), and age should be taken into consideration as well. I mostly started becoming courageous in expression, seeing that my art was needed and valued. And I was part of the biennials and triennials that were organized, I was highly valued, then also in Cagnes—sur—Mer there was an international exhibition where 42—43 states participated, and I was awarded the national merit... for example, in the Yugoslavian Contemporary Arts, there were only two of us who were specified, a Croatian and I.

EK How did they describe your work?

XHXX A pure, autochthonous art with national value.

EK Of Yugoslavia or...?

XHXX Of Yugoslavia and abroad, these were the views of the internationals, the critique that... for example to be honest, the art of Yugoslavia doesn't have such a value in the current world, they even call it a province. But, a critic from Australia wrote in the newspaper, "The works of Xhafa, can go beyond borders, and of this and that..." he mentioned three or four of us.

Part Two

XHXX I was inspired by our people, as I said by our history, folklore and architecture. I consider that nature helped me to easily express my healthy mind in art. Art today represents a nation, a place faster than science because we are someone but as we know, occupation, poverty always dominated and that made us not use that power.

EK Mister Xhafa, while within Yugoslavia, were you allowed to express these national motives?

XHXX Yes, yes.

EK So you didn't have any...

XHXX No, no. There were reactions to how a culture of a nation was shown. There were for example reactions such as for example the one in Sarajevo but those

were as a result of an agreement between them to attack Xhafa. His works, they are nationalist but the artistic values dominated and to be honest those who criticized didn't love my art but I still moved on. I still have courage and find it the easiest to express myself through art, the healthy mind that I consider I have and I am able to express the culture we have honestly. But, I say that we express our healthy mind easier in art. I had a lot of pressure not to be accepted as a teacher at the University but I came to the point where I got involved.

EK Which year, can you tell us more...

XHXX Yes, in '74 I started working as a teacher. I was close to the students, my pedagogical method was supported by students, my abilities were understood because I was always a supporter of the idea that the students should learn as soon as possible and become independent, not leave it to time because time flies and so I was very committed to teaching, I was close to the students and they didn't lack success.

EK What did you teach them, what kind of art history did you teach them, what was the, what was...

XHXX I generally taught them about figurative history, I taught them and told them, "It is good to be inspired by literature but to not take anything directly. Don't trust those, any professor, that says that you have to be a master in order to be able to steal [copy], because stealing is easy." Youngsters at the Academy are very smart but they don't know how to use that smartness. And with the right methods, they can use that power very fast and express it in art.

I tried and somehow I was successful in expressing honesty towards a work, be it living nature or whatever... imagined, to know how to express it, to know how to realize it (coughs), in order for that let me call it half—work to be close to the audience, and to go even further to be closer to

ka fillu, po thom, ndoshta me mu pak (qeshë), edhe mosha është pak në pyetje. Unë ma tepër fillova me marrë guxim në shprehje, t'ua pa që arti im po duhet, po vlerësohet. Edhe këto bienalet, trienallet që janë organizu ka dy here, tri here kom marrë pjesë, jom vlerësu lartë, mandej edhe në Cagnes—sur—Mer ka qenë ekspozita ndërkombëtare, 42—43 shtete kanë marrë pjesë, mua më është nda merita nacionale... shembull, në Austri arti bashkohor Jugosllav, dy vetë na kanë veçu, mua edhe një kroat.

EK Qysh e përshkrujshin punën tande?

XHXX Nji art, i pastërt, autokton, me vlerë nacionale.

EK Jugosllavisë a të...?

XHXX Jugosllavisë edhe botës jashtme, qito mendime edhe botës jashtme, kritika... se për shembull drejtën me ju tregu, arti Jugosllav nuk ka një peshë në botën e sotme, edhe e quajnë provincë. Mirëpo, qe, në Australi një kritik po shkrun në gazeta, këtu, "Mund t'i kalojnë kufijtë por veprat e Xhafës, e atij e atij..." tri katër vetë na përmendi.

Pjesa e Dytë

XHXX Unë jom inspiru nga njeriu ynë, nga historia si thashë nga folklori, arkitektura. Atë mendje të shnoshë që e konsideroj pak që e kom ma s'lehti natyra më ka ndihmu ta shprehi për art. Arti sot e përfaqëson një popull, një vend ma shpejtë se shkenca se ne jemi dikush por siç e dijmë gjithnjë ka dominu okupimet, skamja edhe e ka ndiku që ne mos të shfrytëzojmë atë fuqi, atë fuqi me shfrytëzu.

EK Zoti Xhafa, a ju është leju mrena Jugosllavisë sa keni qenë, a ju është leju me shpreh edhe qet' farë, qeto motivet ma nacionale?

XHXX Po, po

EK Domethonë nuk keni pasë naj...

XHXX Jo, jo. Aty—këtu ka pasë reagime qysh po paraqitet një kulturë e një kombi. Ka pasë ndonji reagim, për shembull në Sarajevë mirëpo ato me njif-

arë marrëveshje në mes tyre hajde ta sulmojmë Xhafën. Punimet e tij janë nacionaliste, mirëpo vlera artistike ka qenë dominante edhe të drejtën me të tregu edhe ata që kanë kritikë, nuk ma kanë deshtë, artin tim nuk ma kanë deshtë ajo prapë ka ecë. Edhe sot kom guxim me shprehë ma së lehti në art, atë mendje të shnoshë që e konsideroj që e kom, jom në gjendje me e shprehë në mënyrë të sinqertë edhe kuptohet me një kulturë që ne e kemi. Mirëpo, më tepër thom me atë mendje të shnoshë që e kemi edhe lehtë e shprehim në art. Kom pasë presione mos m'u pranu në fakulltet si mësimdhënës mirëpo vjen dej te ajo që inkuadrohna.

EK Në cilin vit, a po na tregon kështu pak ma detajisht?

XHXX Po, '74—tën kom fillu me punu si pedagog. Kom qenë i afërt me studentë, është përkrahë metoda ime pedagogjike te studentët, u kuptuan ato aftësitë e mia se unë gjithnjë kom shku nga ajo që studenti shpejt të mëson, të pamvarësohet. Jo me ia lanë kohës se koha shpejtë po ecë edhe kështu që kom qenë i përpikët në mësimdhanje, kom qenë i afërt me studentë edhe sukseset e studentëve nuk kanë mungu.

EK Me çka i mësojshit, çfarë historie të artit ua mësojshit, çka ish, çka ish...

XHXX Unë në përgjithsi në lidhje me histori figurative i mësojsha dhe thojsha, "Mirë o me u inspiru nga literatura, por jo drejtpërdrejtë me marrë diçka. Mos besoni dikujt që thojnë, ndonji profesor, duhet me qenë mjeshtër me ditë me vjedhë, se lehtë o me ditë me vjedhë". Të rijtë në akademi jonë shumë të mençëm mirëpo atë mençuri nuk dijnë me shfrytëzu. Eh me metodat e mirëfillta ai mund ta shfrytëzon shpejtë atë fuqinë edhe me shpreh në art.

Unë jom mundu, edhe deri dikun kom pasë sukses me e shprehë sinqeritetin ndaj një pune, qoftë ajo natyrë e gjallë, qoftë ndonji... imajnum me ditë me shpreh, me ditë me e realizu (kollitet), ajo mund ta quaj si gjysë veprë me

the critics than to us. I told my students, "If we only become slaves of nature, objects, then we will slowly move forward, we will give from ourselves very slowly, use it because our minds can get passive, your mind can get passive, our power can become passive if we don't use it."

EK What kind of art system existed?

XHXX Current art, contemporary art. I said before that I never competed anywhere but they invited me, somehow they knew me, they knew my art and notified me. I participated, I was valued, I gained the courage and got engaged in my activity, I saw that I could use my artistic abilities.

EK You said that you were valued, were there art historians or art critics at the time when you worked?

XHXX Where do you mean, here?

EK In Kosovo as well as in Yugoslavia, I am interested to know how they invited you to the first exhibitions, how did that happen to an artist?

XHXX There were competent critics in the former Yugoslavia, honest ones, but they were rare. We also had some critics in Kosovo but their critique wasn't honest, people can write critiques today as well but not related to content. Not with the right artistic values, but modern art started a little too late for us because it is known that we were always isolated, not supported. But slowly art as such is moving very fast and has moved more than other fields, because we can only represent a nation and a country through art, it is more difficult through science because art is readable, understandable.

EK Can you tell us how were the '90s for you in the Academy and for the Kosovo artists, how did you get through all those, that difficult part.

XHXX I can say that the '90s were an artistic event here, mutual exhibitions were organized and good words were written about those exhibitions, some individuals started being dis-

tinguished of course their values started being acknowledged, it was not like the politics which was based on class divisions, state politics. Art was supported in Kosovo during former Yugoslavia as well.

EK I was talking about the '90s when you were chased from the University, the Gallery and other institutions, how, what happened to art at that time, in the '90s?

XHXX In the '90s there was a very dark atmosphere at the University, the University in Albanian language was interrupted. We started giving lectures in private houses,⁷ there was pressure from the back—then government of Serbia but however there was a movement in which some not—so—big exhibitions were organized in coffee shops, there were no exhibitions being organized in an atmosphere of freedom. It was impossible to organize exhibitions on the national level, I mean the exhibition has content, because the back—then regime was former Yugoslav and there was pressure not in art but in politics, but the politics affected the non—development of art in Kosovo as well.

EK What was the meaning of art at that time... what was the meaning of art at the time when you had no university, no gallery... how did you motivate students to study art?

XHXX The art... some exhibitions were organized in coffee shops, they had a kind of a local affirmation, there was no motivation, no stimulation for artists because art was limited, we had no good relations to other republics, we were isolated, it was the politics that isolated art as well. It was very difficult to organize big exhibitions with values because we had no conditions. We had no support, I mean in the '90s we had no support or motivation from the government to organize exhibitions, every artistic gathering was self—financed.

EK Did your art change at that time?

XHXX How?

By 1991, after Slobodan Milošević's legislation making Serbian the official language of Kosovo and the removal of all Albanians from public service, Albanians were excluded from schools as well. The reaction of Albanians was to create a parallel system of education hosted mostly by private homes.

qenë afër publikut edhe me shku edhe ma larg, me qenë afër kritikut se ne. Ju thojsha studentëve, "Nëse ne vetëm bohëm rob të natyrës, objektit, atëherë shumë kadale mundemi me ecë përpara, shumë kadale mundemi me dhonë, me shfrytëzu edhe mundet m'u pasivizu mendja jonë, mendja juve atë fuqi që kemi mundemi me pasivizu nëse nuk e shfrytëzojmë".

EK
XHXH Çfarë sistemi i artit ka ekzistuar?
Arti ma shumë, arti i sotëm, arti bashkëkohor. Unë thashë më parë asnjherë s'kam konkuru por më kanë ftu, më kanë njoftë pak a shumë, ma kanë njoftë artin tim edhe më kanë njoftu. Kom marrë pjesë, më kanë vlerësuar, kom përfitu guximin dhe atë vlerësim edhe ma shumë jom kyçur në vepërimitarinë time që kom... e kom pa që atë, aftësitë e mia muj me i shfrytëzu me art.

EK
XHXH Ju thatë që ju kanë vlerësuar, a ka pasë në atë kohë historian të artit ose kritik të artit në kohën kur keni punu ju?

Ku po mendoni, këtu?

EK
XHXH Në Kosovë edhe në Jugosllavi se po më intereson qysh ju kanë ftu nëpër ekspozitat e para qysh ka ndodhë ajo për një artist?

Po në ish—Jugosllavi ka pasë kritik të mirëfilltë, të sinqertë, por edhe ata kanë qenë të rrallë pak. Në Kosovë po ashtu kemi pasë disa kritik, por me kritikë pak a shumë jo aq të sinqertë, kritikë me shkru, edhe sot dinë me shkru mirëpo jo në lidhje me përmbajtje. Jo me vlerat e mirëfillta artistike. Mirëpo edhe te ne arti modern ka fillu pak me vonesë kuptohet se kemi qenë gjithnji të izoluar, jo të përkrahur. Mirëpo, dalë kadale arti si art shumë ma shpejtë po ecë edhe ka ecë se sa lamitë tjera, se ne me art mundemi me përfaqësu një popull, një vend, me shkencë vështirë se arti është i lexushëm, i kuptushëm.

EK
XHXH A mundesh me na tregu qysh kanë qenë të '90—tat për juve, akademinë edhe artistat e Kosovës, qysh i keni kalu ju krejt ato, atë pjesë të randë?

Vitet e '90—ta ka qenë një ng-

jarje artistike muj me thonë këtu te ne, jonë organizu këto ekspozita të përbashkëta, jonë shkru fjalë të mira për këto ekspozita, kanë fillu m'u veçu disa individë normal që jonë pa vlerat e tyre, s'ka qenë si politika që ka qenë politikë klasore, shtetërore. Arti disi u përkrahë në ish—Jugosllavi edhe poashtu në Kosovë.

EK
XHXH Për '90—tat e pata fjalën kur ju kanë qitë prej universitetit edhe Galerisë edhe institucioneve tjera, qysh, çka ka ndodhë me art në atë kohë, të '90—tat?

Vitet e '90—ta ishte një atmosferë shumë e zymtë në universitet, ndërprehet universiteti në gjuhën shqipe. Fillojmë me ligjërë nëpër shpija private, ishte një presion nga qeveria e atëherëshme, po mendoj Serbisë, mirëpo prapë ishte një lëvizje ku u organizojshin ekspozita jo të mëdhaja, nëpër kafe, kafiqa, jo m'u organizu ndonji ekspozitë kështu me një atmosferë të lirë. Ishte e pamundur me organizu ekspozita, po mendoj të nivelit Kosovar, po mendoj që ka një përmbajtje. Ekspozita kishte me pasë se regjimi atëherëshëm pak, ish—Jugosllav, ishte pak një presion jo në art, në politikë, mirëpo politika ndikonte edhe në jo zhvillimin e artit në Kosovë.

EK
XHXH E çfarë kuptimi kish arti në këtë kohë... çfarë kuptimi kish arti në këtë kohë kur nuk kishit as universitet, as Galeri, as... qysh e motivojshit ju studentin me studiu art?

Arti... u organizojshin disa ekspozita nëper lokale, kafiqa e kishin njëfarë afirmimi lokal, nuk kishte nxitje, një stimulim për artistë, se arti ishte i kufizuar, nuk kishim marrëdhënie të mira me republikat tjera, ishim të mbyllur, si politika që ishte mbyllë edhe arti te ne. Shumë vështirë ka qenë me organizu ndonjë ekspozitë të madhe, me vlera, s'ishin kushtet atëhere. Nuk kishte përkrahje edhe nga të '90—tat po mendoj nga qeveria s'kishim përkrahje, stimulim për organizimin e ekspozitave, ishte një vetëfinancim për ndonji manifestim artistik.

EK Did your art change at that time, did the political circumstances have any influence on you and your work?

XHXX No, no, they didn't have any influence, I continued working as always, I had the will to work and that's it. Lastly, I have exhibited less abroad, looks like the politics are working now, they're dominating. There are exhibitions organized, the time has come that I can hardly exhibit in Albania the next year, and there was a barrier among artists here as well, there is the lack of support, jealousy but I have always trusted myself that good art moves forward. I think that in the future our state should support art because it is the only field that can get a nation, a country, to move forward.

EK A ka ndërru arti juj në këtë kohë?

XHXX Si?

EK Arti juj a ka ndërru në këtë kohë a ka, këto rrethana politike a kanë pasë ndikim edhe në juve edhe në punën e juj?

XHXX Jo, jo s'ka pasë kurrëfarë ndikimi unë kom punu gjithnji, kom pasë vullnet me punu edhe qe. Ma pak kom ekspozu në kohën e fundit në botën e jashtme, si duket tash për tash politika po funksionon, po dominon. Aty këtu po organizohen këto ekspozita që menxi ka ardhë koha unë me ekspozu në Shqipëri vitin e ardhshëm edhe këtu te ne ndër artistë ka pasë njifarë barriere që normal te artistët është ajo farë mospërkrahja, xhelozia mirëpo gjithnji kom besu në veti se arti i mirëfilltë ecë, ka me shku ma tutje. Kujtoj në të ardhmen edhe shteti ynë duhet me përkrahë artin se e vetmja lami është që mundet me afirmu një popull, një komb, një shtet.



0804
Agim Rudi

The legend of corn
40x50x23 cm
wood, 1986

0804
Agim Rudi

Legjenda e misrit
40x50x23 cm
dru, 1986



0156
Alije Vokshi

Portrait
73x88 cm
oil on canvas, 1972

0156
Alije Vokshi

Portret
73x88 cm
vaj në pëlhurë, 1972




0627
Blerim Luzha

Design II
30x90 cm
mixed media, 1973

0627
Blerim Luzha

Dezen II
30x90 cm
teknikë e kombinuar, 1973



SP

0591
Shyqri Nimani

Untitled
50x70 cm
seriography, 1974

0591
Shyqri Nimani

Pa titull
50x70 cm
seriografi, 1974




0700
Tomislav Trifić

Man and space
75x50 cm
mixed media, 1980

0700
Tomislav Trifić

Njeriu dhe hapësira
75x50 cm
teknikë e kombinuar, 1980



0344
Xhevdet Xhafa

Why
76x53.5 cm
graphics, 1971

0344
Xhevdet Xhafa

Pse
76x53.5 cm
shtyp grafikë, 1971

Katalogimi në botim—(CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

398(=18):73/76

Galeria Kombëtare: projekti i historisë gojore / udhëheqëse e hulumtimit,
Erëmirë Krasniqi; transkriptimi, Donjetë Berisha; përktheu, Aurela Kadriu, Dafina
Tahiri. - Prishtinë: Galeria Kombëtare e Kosovës, 2018. — 248 f.: ilustr.; 33 cm.

1. Krasniqi, Erëmirë 2. Galeria Kombëtare e Kosovës 3. Iniciativa për Histori Gojore
Titulli dhe teksti paralel në gjuhën shqipe dhe angleze.

ISBN 978-9951-587-87-7

ISBN 978-9951-587-87-7



This research—based publication is a contribution to USAID Transformational Leadership Program—Citizens Corps. The views and opinions expressed in this publication are those of the researcher and do not necessarily reflect the official policy or position of USAID TLP Citizens Corps. Assumptions made within the analysis are not reflective of the position of any government entity.

Ky publikim hulumtues është kontribut për USAID Transformational Leadership Program—Citizens Corps. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë publikim janë të hulumtuesës dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë politikën zyrtare apo pozicionin e USAID TLP—Citizens Corps. Supozimet e bëra në kuadër të këtij publikimi nuk reflektojnë qëndrimin e asnjë entiteti qeveritar.







galeriakombetare.com
oralhistorykosovo.org